



BANKA E SHQIPËRISË

DIASPORA DHE PAGESAT

DHJETOR 2019

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,

Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11

Faks: + 355 4 2419408

E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 150 kopje

Grupi i punës që punoi për hartimin e këtij botimi:

*Argita Frashëri, Ledia Bregu, Valentina Semi, Rudina Lilaj, Enian Çela, Elona Dushku,
Lindita Vrioni, Arlinda Koleniço*

PËRMBAJTJE

FJALA PËRSHËNDETËSE	5
MEDALJONI I DIASPORËS: KONTEKSTI, REALIZIMI DHE MESAZHI	7
Konteksti	7
Realizimi i skulpturës	8
Dy fjalë nga autori mbi frymëzimin për medaljonin kushtuar diasporës	9
TREGU I PAGESAVE NË SHQIPËRI DHE NEVOJA PËR REFORMIM - KONTRIBUTI I PROJEKTLIGJIT TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE NË ZHVILLIMIN E PAGESAVE (DIREKT) DHE NË REMITANCAT (INDIREKT)	10
Hyrje	10
Panoramë e tregut shqiptar të pagesave	10
Ndërhyrje për reformimin e tregut shqiptar të pagesave me vlerë të vogël	16
Risitë kryesore të projektligjit	16
Kontributi i projektligjit në perspektivën e remitancave	19
KOSTOT DHE KURSIMET E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI. DISA NGA REZULTATET KRYESORE	20
Hyrje	20
Instrumentet e pagesave dhe kostot e tyre	22
Kahu i kërkesës	22
Konsumatorët	22
Bizneset	23
Agjencitë shtetërore	24
Kahu i ofertës	24
Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e infrastrukturës së pagesave	24
Kostot totale për ekonominë në tërësi	25
Përfundime	28
STATISTIKA PËR REMITANCAT	30
NDIKIMI I MBAJTJES SË PARASË “CASH”	31
Hyrje	31
Për individët	31
Për bizneset	31
Impakti i kombinuar	32
FAMILJET DHE REMITANCAT: EVIDENCË NGA VROJTIMI MBI FINANCAT DHE KONSUMIN E FAMILJEVE SHQIPTARE	35
Hyrje	35
Analiza e rezultateve të vërtetimit	38
Profili i familjeve që përfitojnë remitanca	38
Përmbledhje e gjetjeve	43

FJALA PËRSHËNDETËSE

Të dashur lexues,

“Diaspora dhe Pagesat” është botimi i dytë i Bankës së Shqipërisë, kushtuar emigracionit dhe diasporës. Këtë radhë jemi ndalur në risitë e sistemeve të pagesave dhe në mbështetjen që ato japin në thithjen dhe përdorimin me efikasitet të shtuar të dërgesave valutore nga emigracioni dhe diaspora. Ky botim pason atë të vitit të kaluar, të titulluar “Remitancat: Një mbështetje për zhvillim”, çka dëshmon për një angazhim analitik të Bankës së Shqipërisë në lidhje me emigrantët, remitancat dhe përdorimin efektiv të tyre.

Migracioni, në tërësinë e dimensionit të tij kulturor, social dhe ekonomik, përbën një nga shtyllat kryesore të axhendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për uljen e varfërisë. Një nga mjetet e rëndësishme për materializimin e objektivave të vendosur është rritja e përfshirjes financiare të familjeve pritëse të remitancave, për të mundësuar efektivitet maksimal në përdorimin e të ardhurave nga emigrantët në vendet e origjinës.

Të dhënat e fundit të bilancit të pagesave tregojnë se të ardhurat nga emigrantët vazhdojnë të mbeten një fluks i rëndësishëm financimi për ekonominë shqiptare. Mesatarisht gjatë periudhës 2008-2018, remitancat kanë përbërë 12% të PBB-së së Shqipërisë.

Nga ana tjetër, sipas Vrojtimit mbi Financat dhe Konsumin e Familjeve Shqiptare, zhvilluar së fundmi nga Banka e Shqipërisë, vlerësohet se gjatë vitit 2018, 23% e familjeve shqiptare kanë marrë të ardhura në formën e remitancave. Për shumicën e familjeve, këto të ardhura vlerësohet të përbëjnë burimin kryesor për përballimin e shpenzimeve të konsumit dhe të investimeve.

Pavarësisht peshës që ato mbartin, eksperiencia ndërkombëtare dhe ajo vendase kanë treguar se ky burim financimi është larg niveleve potenciale të shfrytëzimit të tij. Një përdorim më efektiv i këtyre fondeve do të sillte një vlerë të shtuar për ekonominë shqiptare. Pengesat kryesore që frenojnë efektin multiplikativ të remitancave, lidhen kryesisht me kostot e larta dhe kanalet joformale të dërgimit të tyre. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë në vazhdimësi ka ndërmarrë nisma dhe reforma për të zbehur ndikimin e këtyre pengesave, si dhe rritjen e përfshirjes financiare.

Nga analizat e kryera në bashkëpunim me Bankën Botërore, rezulton se instrumentet e pagesave në Shqipëri kanë kosto ende të larta, jo vetëm për agjentët e tregut, por edhe për ekonominë në tërësi. Evidentohet gjithashtu se cash-i është forma kryesore e pagesave në ekonomi dhe mbajtja e vlerave monetare në formë cash-i nga publiku i gjerë (individët dhe bizneset) mbart kosto të qenësishme ekonomike. Sipas studimeve empirike, vlerësohet që në mungesë të këtyre kostove, rritja ekonomike për vitet 2014-2018 do të ishte rreth 3.8%, 0.7 pikë përqindje më e lartë se norma faktike.

Banka e Shqipërisë, në funksion të objektivit të saj për një sistem pagesash të sigurt dhe efektiv, si dhe të zgjerimit të përfshirjes financiare të popullsisë, ka identifikuar nevojat për reformim të tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe nxitjen e përdorimit të pagesave elektronike, si një alternativë më efikase dhe më pak e kushtueshme për të gjithë agjentët ekonomikë.

Masat e para të marra në këtë drejtim lidhen kryesisht me përmirësime ligjore, të cilat në vitet në vijim do të pasohen nga zhvillime infrastrukturore dhe nga kultivimi i kulturës financiare të popullsisë. Këto përmirësime kanë për qëllim të akomodojnë risitë teknologjike në fushën e pagesave, të rrisin efikasitetin nëpërmjet nxitjes së konkurrencës, si dhe të sigurojnë transparencë dhe mbrojtje për konsumatorin.

Qëllimet e sipërcituara do të jenë mjetet tona për të krijuar një treg bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurt dhe efikase, si dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh, që përmbushin nevojat e përdoruesve të aftë financiarisht për të kryer pagesa në të gjithë vendin. Objektivi ynë është që përmirësimet në tregun e pagesave me vlerë të vogël t'u japin qytetarëve shqiptarë, por edhe emigrantëve dhe diasporës, më shumë mundësi zgjedhjeje sa i takon pikave që ofrojnë kryerjen e transaksioneve të përditshme, në mënyrë të lehtë dhe me kosto efektive.

Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është dhe hartimi i projektligjit "Për shërbimet e pagesave", i cili transponon direktivën e rishikuar të Bashkimit Evropian "Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm". Dëshiroj të theksoj se Direktiva në fjalë përbën një risi dhe për vetë tregun evropian, duke u karakterizuar si një akt ligjor, i cili, duke promovuar inovacionin dhe duke nxitur konkurrencën nëpërmjet shërbimeve dhe aktorëve të rinj në treg, do të reformojë dhe digjitalizojë tregun e pagesave me vlerë të vogël.

Në kontekstin shqiptar, miratimi dhe zbatimi nga tregu i këtij ligji vlerësohet se do të ketë një kontribut thelbësor në krijimin e shërbimeve me kosto të ulëta dhe lehtësisht të aksesueshme nga publiku i gjerë. Në terma konkretë, ky projektligj vlerësohet se do të nxisë ndjeshëm konkurrencën në treg dhe do të promovojë shërbime inovative, mbështetur gjithashtu edhe me një regjim prudencial nga pikëpamja e mbrojtjes së konsumatorit. Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, projektligji synon edhe zgjerimin e ofrimit të shërbimeve nga bankat në të gjithë territorin shqiptar (përfshirë zonat rurale).

Përtej reformave strukturore në tregun e pagesave me vlerë të vogël, gjatë kësaj periudhe i është kushtuar vëmendje e veçantë edhe vijimit të dialogut periodik me sistemin bankar, me Ministrinë e Shtetit për Diasporën, me agjencitë shtetërore dhe me aktorë të tjerë relevantë të brendshëm dhe të huaj.

Duke shpresuar se ky botim do të jetë një kontribut më shumë për njohjen e këtyre sfidave dhe vendosjen e tyre në rrugën e zgjidhjes, ju uroj lexim të këndshëm!

Gent Sejko

Guvernator

MEDALJONI I DIASPORËS: KONTEKSTI, REALIZIMI DHE MESAZHI

Konteksti

Me rastin e zhvillimit të Samitit II të Diasporës Shqiptare, Banka e Shqipërisë vendosi të emetojë një Medaljon përkujtimor kushtuar Diasporës Shqiptare, e cila luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Rëndësia e Diasporës lidhet jo vetëm me shkëmbimin e kulturës dhe eksperiencave, zhvillimin e kapitalit human, por edhe me prurjet e remitancave, të cilat ndikojnë ndjeshëm në zbutjen e varfërisë dhe të problemeve sociale për shtresa të ndryshme të shoqërisë.

Në këtë kontekst, piktorja Brikena Berdo disenoi Medaljonin “Diaspora Shqiptare”, si simbol i nderimit dhe përkujtimit të kësaj vlere të madhe të kombit tonë.

Medaljoni është konceptuar të realizohet prej metali të çmuar argjendi, me një diametër prej 4 cm. Ai ka një ndërtim qendror, ku në mes qëndron globi. Harta e Shqipërisë përfaqësohet simbolikisht nga një pikë e vogël simbolike e kuqe, e vendosur në një kënd jo simetrik, qëllimisht të vogël e simbolikisht të lënë mënjane, por të evidentuar me ngjyrën simbol të vendit tonë. Rrotull globit, sillen silueta njerëzish në ecje, të cilët portretizojnë dramën e një eksodi. Ideja e eksodit projektohet në mendjen e shikuesit përmes ritmit të siluetave. Ato kanë detaje të prera, për të shmangur personalizimin dhe evidentuar konceptin.

Në shpinën e medaljonit vendoset globi, por aty shpaloset shqiponja dykrerëshe, trupi i të cilës copëtohet nga kufijtë e vendeve të rajonit dhe në zemër të shqiponjës është Shqipëria e kuqe. Kjo zgjidhje simbolike jep idenë e shpërndarjes së shqiptarëve anembanë botës, por zemrën dhe shpirtin i kanë në vendin e tyre. Ajo rrethohet me vargjet e rilindësve që i këndojnë mallit, dashurisë për atdheun, gjuhës, flamurit dhe bashkimit, pa dallim feje e krahine.



Realizimi i Skulpturës

Po për këtë event, si simbol dhe ikonë e samitit u realizua një skulpturë e medaljonit, e cila u vendos në hyrje të Samitit. Për realizimin e skulpturës, punoi skulptori, artisti Kreshnik Xhiku. Skulptura u ekspozua më pas edhe në ambientet e bibliotekës së qytetit të Lezhës në kuadër të aktiviteteve përkujtimore me rastin e 475-vjetorit të Lidhjes së Lezhës, organizuar nga Qeveria Shqiptare më 2 mars 2019.

Sot ajo qëndron e ekspozuar në ambientet e Bankës së Shqipërisë, si një vepër arti në nderim të gjithë shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit, si dhe kontributit të tyre në rritjen ekonomike, sociale dhe politike të vendit tonë.



DY FJALË NGA AUTORI MBI FRYMËZIMIN PËR MEDALJONIN KUSHTUAR DIASPORËS¹

Koncepti i "Diasporës" nuk është i ri për shqiptarët. Sa herë dëgjojmë të përmendet "diaspora", na vijnë ndër mend arbëreshët, arvanitasit, rilindësit dhe eksodet e mëdha që kanë lënë gjurmë në memorien e kombit, si për sa i përket dhimbjes së largimit prej situatave ekonomike, politike e sociale, ashtu edhe ndikimit të madh që diaspora pati në zhvillimin e vendit, por edhe në ruajtjen e vlerave të kulturës, të artit dhe të traditës kombëtare. Në historinë e saj të gjatë, diaspora shqiptare ka qenë dëshmi e gjallë e rëndësisë së traditës dhe ndjenjës së fortë të kolektivitetit për kombin tonë.

Në fëmijëri këtë nocion e kam perceptuar si tërësisht të idealizuar, duke e lidhur pandashmërisht me patriotizmin, personifikuar në figurat e vëllezërve Frashëri, Jeronim de Radës, Luigj Gurakuqit, Ismail Qemalit, Fan Nolit, Faik Konicës, Gjergj Fishtës, Martin Camaj etj. dhe vargjet e tyre të ndjera kushtuar vendit, gjuhës, flamurit, por pa qenë e ndërgjegjshme mbi rrethanat prej nga buronte gjithë ky përkushtim. Më vonë, me ardhjen e viteve '90, përjetova një ndjesi të çuditshme shkëputjeje drejt së panjohurës - shoqëruar me shumë lot e dhimbje - të anijeve që kapërcyen detin të tejmbushura me njerëz, që mbanin mbi vete vellon e shpresës për një të ardhme më të mirë.

Para konceptimit të medaljonit, brenda meje që zhvilluar një luftë e brendshme për t'u bërë ose jo pjesë e eksodit. Një pjesë e imja dëshironte me forcë të largohej, për një të ardhme më të mirë për veten dhe për fëmijën tim, ndërsa pjesa tjetër luftonte të qëndroja, e kapur fort pas vendit tim, që është sfond i jetës sime, ku kam nënë e vëlla, e ku prehen eshtrat e tim eti. Gjithçka e imja më mban këtu, prania prindërore dhe të gjitha ndjenjat që burojnë prej saj, dëshira që im bir të rritet me njerëzit e dashur. Të gjitha këto të mbajnë të lidhur fort me vendin tënd, por dilemat e ekzistencës ngrenë tallazin e tyre dhe e bëjnë të dhimbshme këtë zgjedhje.

Këto të gjitha, mendova, i kanë përjetuar dhe "ata", duke e vënë veten në vendin e tyre.

Rreth këtyre përsiatjeve e dilemave ndërtohet i gjithë koncepti i medaljonit. Të dyja faqet mbartin simbolika të konceptit të diasporës.

Njëra është "ikja", drama që ka brenda largimi, shkëputja nga trangu familjar e shoqëror; ndërsa tjetra është "kthimi", një kthim idealist, me kontribute, me dashuri e me trashëgimi vlerash. Kjo paraqitet emocionalisht dhe konceptualisht në globin tonë, ku shpaloset shqipsonja dhe ngjyra e kuqe e flamurit, një hartë e rajonit dhe Shqipëria e kuqe, në zemër të shqipsonjës dykrerëshe.

Ndërsa "Kthimi" është ajo "faqe e medaljonit" që të mban të lidhur me vendin tënd, të kthen përsëri. Është dëshira që sakrifica të mos jetë e kotë. Është kontributi që i jep kuptim asaj ikjeje, dhe të kthen me shpirt tek rrënjët e tua. Kontribut ky sa "ideal" po aq edhe "material" – një dëshirë për të dhënë, për të bërë mirë e për të lënë një gjurmë. Pasqyrë e shpirtit bujar të një kombi, që në çdo kohë i ka dëshmuar vlerat e tij.

¹ Përgatiti Brikena Berdo.

TREGU I PAGESAVE NË SHQIPËRI DHE NEVOJA PËR REFORMIM

- KONTRIBUTI I PROJEKTLIGJIT TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE NË ZHVILLIMIN E PAGESAVE (DIREKT) DHE NË REMITANCAT (INDIREKT)²


HYRJE

Institucionet ndërkombëtare si Banka për Rregullim Ndërkombëtar dhe Banka Botërore³ kanë evidentuar rëndësinë që ka zhvillimi i tregut të pagesave me vlerë të vogël për kanalizimin e remitancave nëpërmjet kanaleve zyrtare (bankave dhe institucioneve financiare jobanka). Nga ana tjetër, këto institucione theksojnë edhe rëndësinë që kanë remitancat dhe kanalizimi i tyre nëpërmjet institucioneve bankare e financiare për rritjen e përfshirjes financiare të popullsisë. Në këtë këndvështrim duket se përfshirja financiare, zhvillimi i tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe remitancat janë faktorë që lidhen ngushtë me njëri-tjetrin.

Panoramë e tregut shqiptar të pagesave

Siç është evidentuar dhe më parë, Shqipëria paraqet një përfshirje të ulët financiare krahasuar jo vetëm me vendet e Bashkimit Evropian por dhe me ato të rajonit, një zhvillim ky që reflektohet edhe në një zhvillim të kufizuar të tregut të pagesave me vlerë të vogël.

Nga ana tjetër, Shqipëria është një vend pritës remitancash, ku vlera e tyre për vitet e fundit rezulton në rreth 12% të Produktit të Brendshëm Bruto. Pavarësisht flukseve relativisht të larta të remitancave që hyjnë në Shqipëri, një përqindje e konsiderueshme e tyre dërgohet nëpërmjet kanaleve joformale⁴. Edhe në rastet kur dërgesat kanalizohen përmes sektorit financiar duket se ka një preferencë të lartë për përdorimin e institucioneve financiare jobanka (IFJB), të cilat kryejnë shërbime pagesash dhe



² Punoi: Valentina Semi.

³ BRN dhe Banka Botërore, General principles for international remittance services, Janar 2007.



⁴ Grupi i Bankës Botërore në kuadër të Programit të Remitancave dhe Pagesave, i financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), në vitin 2016 ndërmori një vërtetim mbi sjelljet financiare të përfituesve të remitancave në gjashtë vende të Evropës Lindore dhe Azisë.

transfertash, ndërkohë që përdorimi i bankave mbetet i vogël. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se IFJB-të në Shqipëri ofrojnë shërbime vetëm me para fizike (cash in/cash out), duke nënkuptuar që të ardhurat nuk kanalizohen në sistemin bankar dhe nuk kanë kontribut të rëndësishëm në përfshirjen financiare të popullsisë, ndërmjetësimin financiar dhe rritjen e mirëqenies të individit dhe të vendit në tërësi.

Për të adresuar ndër të tjera edhe këtë situatë, Banka e Shqipërisë⁵ me mbështetjen e Bankës Botërore ka bërë një sërë analizash dhe studimesh me fokus tregun e brendshëm të shërbimeve të pagesave. Këto studime dhe analiza kanë identifikuar nevojat për reformim të tregut të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri me qëllim zgjerimin e përfshirjes financiare të popullsisë dhe nxitjen e përdorimit të pagesave elektronike në ekonominë shqiptare si një alternativë më efikase dhe më pak e kushtueshme për aktorët ekonomikë dhe ekonominë në tërësi.

Tregu i shërbimeve të pagesave në Shqipëri përbëhet nga bankat, institucionet financiare jobanka, të cilat ofrojnë shërbime pagesash dhe të transfertave, si dhe institucionet e parasë elektronike.

Aktualisht në këtë treg operojnë 12 banka me një rrjet prej 431 degësh. Gjatë viteve të fundit, numri i degëve të bankave është reduktuar, çka nënkupton tkurrje të prezencës fizike të bankave në territorin e Republikës së Shqipërisë, trend i cili shkon në të njëjtin kah me trendin botëror.



⁵ https://www.bankofalbania.org/rc/doc/_Raporti_Remitancat_12168.pdf; https://www.bankofalbania.org/rc/doc/WB_RetailPmt_Abania_shqip_12354_1_12371.pdf


Tabelë 1. Numri i degëve të bankave në prefekturat e Republikës së Shqipërisë

Prefektura	Numri i degëve të bankave 2016	Numri i degëve të bankave 2019	Numri i popullsisë sipas Prefekturës 2019	Raporti i banorëve për degë 2019
Berat	20	19	125,157	6,587
Dibër	9	9	118,948	13,216
Durrës	49	45	290,126	6,447
Elbasan	29	24	274,982	11,458
Fier	39	33	294,747	8,932
Gjirokastrë	18	13	61,423	4,725
Korçë	34	26	207,889	7,996
Kukës	8	7	76,594	10,942
Lezhë	23	22	125,195	5,691
Shkodër	22	19	202,895	10,679
Tiranë	207	184	895,160	4,865
Vlorë	35	30	189,311	6,310

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, 2019.


Nga pikëpamja e shërbimeve të pagesave, bankat ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh, ku mund të përmendim transfertat në formë letër dhe ato elektronike (shërbime *home banking*), kartat e debitit, kreditit dhe të parapaguara, si dhe debitimet direkte (vetëm për klientët e të njëjtës bankë).

Nga pikëpamja e përdorimit të këtyre instrumenteve, pavarësisht mbizotërimit të transfertave të kreditit në formë letër ndër vite, pesha relative e këtij instrumenti ndaj totalit të pagesave ka ardhur duke u tkurrur përgjatë viteve të fundit (Grafik 3). Reduktimi i përdorimit të transfertave në formë letër është reflektuar në një zgjerim të përdorimit të pagesave elektronike si *home banking*, pagesat me karta bankare dhe debitimi direkt.



Nga analizimi i të dhënave të disponueshme diktohet se shërbimet *home banking* po gjejnë gjithnjë e më shumë përdorim në tregun shqiptar. Përdorimi i këtyre shërbimeve që nga prezantimi i tyre në vitin 2005 - ku fillimisht ky produkt ishte i dizenuar kryesisht për bizneset - ka ardhur duke u zgjeruar dhe nga viti 2013 ka rezultuar një përfshirje e gjerë individësh në këtë segment të tregut. Përfshirja e individëve në përdorimin e këtij shërbimi është reflektuar në një ulje të raportit të përdorimit të llogarive (numër transaksionesh për llogari) në vitin 2013, si rrjedhojë e një mungese të familjarizimit të individëve me këtë shërbim, por që në vitet në vijim ka reflektuar rritje të konsiderueshme (Grafik 4).


Grafik 4. Ecuria e numrit dhe vlerës së transaksioneve home banking (majtas) dhe numri i llogarive që i ofrojnë këto shërbime, si dhe përdorimi i tyre (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2019

Pavarësisht zhvillimeve pozitive të lartpërmendura, vlen të theksohet se në krahasim me totalin e llogarive, përdorimi i këtyre shërbimeve mbetet ende i ulët. Vetëm rreth 30% e llogarive të bizneseve i përdorin këto shërbime dhe në rastin e individëve, ky tregues është akoma më i ulët në rreth 10%. Ndërkohë që dhe numri i transaksioneve për 1 milion banorë në vende të ndryshme të rajonit tregon për një nivel të ulët të përdorimit të këtij shërbimi në Shqipëri.


Grafik 5. Numri i transaksioneve home banking për 1 milion banorë në vendet e rajonit (2018)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Raport krahasues për instrumentet e pagesave, 2019.

Një instrument që mund të konsiderohet si relativisht gjerësisht i përdorur në tregun shqiptar është dhe karta bankare. Aktualisht në tregun vendas 12 banka nga 12 janë emetuese kartash dhe vetëm 7 nga to janë edhe pranuese të këtij instrumenti si mjet pagese (ofrojnë Point Of Sale). Gjatë viteve të fundit janë prezantuar edhe shërbimet e pagesave me karta në internet për bizneset shqiptare (e-commerce). Megjithatë, ofrimi i këtyre shërbimeve mund të konsiderohet si tejet i kufizuar, pasi vetëm 3 banka ofrojnë POS-e virtuale (85 POS-e Virtuale në T2 2019).

Grafik 6. Numri i kartave sipas tipologjisë (majtas) dhe infrastruktura për përdorimin e tyre




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga pikëpamja e zotërimit të këtij instrumenti nga publiku i gjerë rezulton se rreth 40% e popullsisë mbi 15 vjeç zotëron një kartë debiti. Ndërkohë, zotërimi i kartave të kreditit paraqitet në nivele shumë të ulëta, në rreth 4.5% të popullsisë mbi 15 vjeç dhe zotërimi i kartave të parapaguara paraqitet edhe më i ulët, duke marrë parasysh që ky shërbim aktualisht ofrohet vetëm nga dy banka në Shqipëri.

Përtej zotërimit të ulët të kartave si mjet pagese në tregun shqiptar dhe infrastrukturës relativisht jo të zhvilluar, siç mund të evidentohet dhe nga krahasimi me disa nga vendet e rajonit, kartat bankare në Shqipëri gjejnë një përdorim të gjerë në kryerjen e shërbimeve bazike siç është tërheqja e *cash*-it nga ATM-të (Automated Teller Machine) (Grafiku 7).


Grafik 7. Numri i ATM-ve, POS-ve si dhe i kartave të debitit dhe kreditit për 1 milion banorë në vendet e rajonit (2018)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Raport krahasues për instrumentet e pagesave, 2019.

Megjithatë, gjatë viteve të fundit është vënë re një zëvendësim gradual i tërheqjeve *cash* nga ATM-të, me pagesat me kartë në POS-e, një tregues që ka arritur në 21% ndaj totalit të transaksioneve me karta për vitin 2019, krahasuar me 5% të këtij treguesi në vitin 2010 (Grafiku 8).

Grafik 8. Ecuria e përdorimit të kartave në ATM dhe në POS (në përqindje ndaj totalit)



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2019.



NDËRHYRJE PËR REFORMIMIN E TREGUT SHQIPTAR TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL

Me qëllim zhvillimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), ka ndërmarrë një reformë për modernizimin e këtij tregu, duke synuar promovimin e përfshirjes financiare të popullsisë dhe nxitjen e përdorimit të pagesave elektronike në ekonominë shqiptare. Kjo reformë parashikohet të arrihet nëpërmjet zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri (2018-2023), e miratuar nga KKSP në muajin qershor të vitit 2018.

Në thelb, kjo strategji përcakton dy objektiva të qartë dhe lehtësisht të matshëm:

- 1) Nxitjen e përdorimit intensiv të instrumenteve moderne të pagesave, për të rritur numrin e pagesave jo me para fizike në rreth 10 pagesa për frymë në vit, deri në fund të vitit 2022.
- 2) Shtimin e mundësive për akses në llogaritë e pagesave, duke arritur në vitin 2022 një raport të zotërimit të llogarisë në nivelin 70% të popullsisë madhore, nga 40% që ishte ky raport në vitin 2017.

Strategjia parashikon në planin e saj të zbatimit një sërë nismash ligjore e zhvillime infrastrukturore për arritjen e objektivave të saj. Një nisëm mjaft e rëndësishme në këtë drejtim e marrë nga Banka e Shqipërisë është hartimi i projektligjit "Për shërbimet e pagesave". Projektligji transponon në legjislacionin shqiptar Direktivën e Bashkimit Evropian "Për shërbimet e pagesave në tregun e pagesave 2". Ashtu si dhe Direktiva, projektligji përbën një risi dhe revolucion nga pikëpamja e promovimit të inovacionit, duke prezantuar dhe rregulluar në tregun e pagesave një sërë aktorësh dhe shërbimesh pagesash inovative.

Risite kryesore të projektligjit

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji vlerësohet se do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e konkurrencës dhe inovacionit në fushën e pagesave me vlerë të vogël, duke promovuar kështu efikasitetin e tyre dhe reduktimin e kostove që mbart përdorimi i tyre. Shërbimet inovative të promovuara nga ky projektligj konsistojnë në shërbimet e inicimit të pagesave dhe shërbimet e informimit mbi llogaritë individuale në institucione financiare të ndryshme. Një koncept i ri i krijuar nga projektligji është dhe institucioni për shërbimin e llogarisë, që përfaqëson konceptin e njohur si "bankë e hapur". Kjo nënkupton që bankat, të cilat tradicionalisht mbajnë llogaritë e klientëve, do të kenë detyrimin të informojnë institucionet, të cilat ofrojnë dy shërbimet inovative (të inicimit të pagesave dhe të informimit mbi llogarinë mbi disponueshmërinë e fondeve ose gjendjen e llogarisë) me qëllim final kryerjen e pagesave.

Vizioni i strategjisë është "Të krijojë një treg bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, mbështetur në një infrastrukturë të sigurt dhe eficiente, dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh të pagesave, që përmbushin nevojat e përdoruesve të aftë financiarisht për të kryer pagesa në të gjithë vendin. Qëllimi i strategjisë është që përmirësimet në tregun e pagesave me vlerë të vogël t'u japin qytetarëve shqiptarë më shumë mundësi zgjedhjeje të vendeve të ndryshme për të kryer transaksionet e tyre të përditshme, në mënyrë të lehtë dhe me kosto efektive, duke mbështetur objektivin e një përfshirjeje më të gjerë financiare."

Nevojat dhe detyrimet e Bankës së Shqipërisë për hartimin e projektligjit.

- Një detyrim në kuadër të integritetit evropian dhe më konkretisht përmbushjen e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë në lidhje me Kapitullin 4 "Lëvizja e Lirë e Kapitalit".
- Parakusht i nevojshëm për integrimin në tregun e përbashkët të pagesave në Euro (Single Euro Payment Area-SEPA).
- Një hap thelbësor në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Tregun e Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023), duke përmbushur një sërë fushash të plan-veprimit të kësaj strategjie.
- Mbështet realizimin e objektivave të përbashkët të Ministrit të Shtetit për Diasporën, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Remitancat dhe Diasporën.

HAPËSIRË INFORMUESE: SHËRBIMET INOVATIVE TË KRIJUARA NGA PROJEKTLIGJI “PËR SHËRBIMET E PAGESAVE”

Shërbimet e reja të promovuara dhe të rregulluara nga projektligji, synojnë të lehtësojnë aksesin e publikut të gjerë në shërbimet elektronike të pagesave, si nga pikëpamja e kostove, ashtu edhe nga lehtësia e përdorimit. Por në çfarë konsistojnë konkretisht këto shërbime inovative?

Institucionet të cilat do të ofrojnë shërbimin e inicimit të pagesave

Ofruesit e shërbimeve të inicimit të pagesave zakonisht i ndihmojnë konsumatorët të bëjnë pagesa në internet dhe të informojnë menjëherë tregtarin për iniciimin e pagesës, duke lehtësuar kështu tregtinë elektronike. Këto institucione mundësojnë kryerjen e blerjeve online edhe nga konsumatorë të cilët nuk zotërojnë një kartë debiti apo krediti, por kanë një llogari bankare të aksesueshme nga interneti. Njëkohësisht, ky lloj shërbimi ofron edhe një alternativë për tregtarin për të pranuar pagesa elektronike, duke nxitur kështu konkurrencën e tregut, jo vetëm nëpërmjet aktorëve por dhe nëpërmjet instrumenteve të ndryshme.

Institucionet të cilat do të ofrojnë shërbimin e informimit mbi llogarinë

Shërbimet e informimit mbi llogarinë u mundësojnë konsumatorëve dhe bizneseve të kenë një pamje të përgjithshme të gjendjes së tyre financiare, për shembull, duke i lejuar konsumatorët të konsolidojnë llogaritë e ndryshme rrjedhëse që mund të kenë me një ose më shumë banka dhe të kategorizojnë shpenzimet e tyre sipas tipologjive të ndryshme (ushqim, energji, qira, kohë të lirë etj.), duke i ndihmuar kështu në buxhetimin dhe planifikimin financiar. Në shumë raste, këto lloj shërbimesh ndihmojnë edhe në identifikimin e alternativës më pak të kushtueshme për kryerjen e pagesave.

Institucionet të cilat do të ofrojnë shërbimin e llogarisë

Emetimi i një instrumenti pagese është një nga shërbimet e pagesave brenda fushëveprimit të direktivës. Secili ofrues i shërbimeve të pagesave, një bankë ose një institucion pagese, mund të emetojë instrumente pagesash. Projektligji me qëllim nxitjen e mobilitetit të instrumenteve të pagesave, pavarësisht institucionit ku klienti ka llogari, krijon konceptin e “Institucionit për shërbimin e llogarisë”.

Por çfarë mundëson ky lloj shërbimi në thelb? Institucionet për shërbimin e llogarisë mundësojnë që ofruesit e shërbimeve të pagesave (bankat, institucionet e parasë elektronike dhe institucionet e pagesave), të cilët nuk administrojnë llogarinë e përdoruesit të shërbimeve të pagesave, të kenë mundësi të emetojnë instrumente të pagesave me karta dhe ekzekutimin e pagesave të kryera me to nga ana e përdoruesit. Më në detaje, ofruesi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet këtyre shërbimeve, mund të informohet, me pëlqimin e përdoruesit, mbi gjendjen e llogarisë në një institucion tjetër dhe kështu të mundësohet ekzekutimi i pagesës duke shmangur kredinë midis palëve.

Vlen të theksohet se instrumentet e pagesës nuk mbulojnë vetëm kartat e pagesave, siç janë kartat e debitit dhe kartat e kreditit, por çdo pajisje të personalizuar ose si rregull të rënë dakord midis emetuesit dhe përdoruesit që përdoret për të iniciuar një pagesë.

Me qëllim promovimin e konkurrencës, projektligji synon të balancojë hapësirat për ofrimin e shërbimeve të pagesave midis bankave dhe institucioneve financiare jobanka. Më konkretisht, për herë të parë në Shqipëri, institucionet financiare jobanka do të kenë mundësinë të hapin llogari pagese dhe të emetojnë instrumente elektronike pagesash, duke zgjeruar alternativat për zgjedhje të publikut të gjerë.

Për të mbështetur krijimin e një ambienti bashkëpunues midis aktorëve, projektligji parashikon dhe disa dispozita të cilat synojnë eliminimin e praktikave bllokuese ndaj institucioneve financiare jobanka për arsye konkurrence. Më konkretisht projektligji:

- a) Sanksionon të drejtën e institucioneve të pagesave për të hapur llogari pranë një banke dhe për ofrimin e shërbimeve përkatëse. Në rast refuzimi, banka duhet të raportojë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë arsyet e refuzimit. Kjo dispozitë synon të eliminojë praktikën abuzive të ndjekura nga bankat në kuadër të *de-risking*.
- b) Sanksionon të drejtën e institucioneve të pagesave për të marrë pjesë në sistemet e pagesave (në mënyrë të drejtpërdrejtë kur këto sisteme nuk janë me rëndësi sistemike dhe në mënyrë të tërthortë nëpërmjet një banke kur ato janë me rëndësi sistemike si në rastin e AIPS).



Projektligji vlerësohet të rrisë transparencën në shërbimet e ofruara nga tregu dhe në krijimin e një kuadri të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit. Vlen të theksohet se projektligji parashikon krijimin e njësie brenda institucioneve për adresimin e mbrojtjes së shërbimeve të pagesave (të ngjashme me atë të kredisë konsumatore), si dhe një njësi të posaçme brenda Bankës së Shqipërisë për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Ky zhvillim është në linjë dhe me rishikimet e fundit të ligjit "Për mbrojtjen e konsumatorit" nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Një risi e rëndësishme e projektligjit, në kuadër të përfshirjes financiare, e cila synon të zgjerojë prezencën e shërbimeve të ofruara nga bankat në të gjithë territorin (përfshirë dhe zonat rurale) do të adresohet nëpërmjet prezantimit dhe rregullimit të modelit të "Bankave që ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve".

Projektligji si dhe nisma të tjera ligjore e rregullative vlerësohet se kontribuojnë në krijimin e institucioneve financiare me një qeverisje të mirëregulluar dhe struktura për administrimin e rrezikut,

duke ndihmuar drejtpërdrejt në nxitjen e sigurisë dhe efikasitetit në tregun e shërbimeve të pagesave. Zbatimi i këtyre praktikave evropiane ndikon dhe në rritjen e besimit ndaj institucioneve shqiptare të pagesave në rrafshin ndërkufitar, duke u reflektuar edhe në shtimin e mundësive të ndërveprimit me institucione të huaja.

Kontributi i projektligjit në perspektivën e remitancave

Projektligji “Për shërbimet e pagesave”, përtej objektivit të përgjithshëm për modernizimin e tregut të shërbimeve të pagesave në Shqipëri, ka një kontribut specifik edhe në segmentin e tregut vendas të remitancave. Ai kontribuon në zgjerimin e gamës së aktiviteteve të MTO⁶-ve, të cilat janë dhe kanali kryesor formal i përdorur nga emigrantët, duke u lejuar hapjen e llogarive të pagesave dhe emetimin e instrumenteve elektronike.

Gjithashtu, projektligji parashikon të drejtën e këtyre institucioneve për të hapur llogari pranë bankave dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme. Pas masave të marra nga institucionet përkatëse për parandalimin e pastrimit të parave, shumë banka, në rolin e bankave korrespondente, mbyllën llogaritë e MTO-ve me qëllim eliminimin e problematikave që mund të hasnin gjatë veprimtarisë me këto institucione. Fenomeni i ashtuquajtur *de-risking*⁷ ka gjeneruar debate dhe në rrafshin ndërkombëtar për efektet negative të krijuara në sektorin e MTO-ve. Direktiva dhe si rrjedhojë edhe projektligji parashikojnë një regjim prudencial për MTO-të në këtë kuadër.

Për më shumë, krijimi i konceptit “të bankës së hapur” krijon parakushtet e nevojshme që këto institucione të kanalizojnë transfertat e remitancave në llogaritë bankare, duke mundësuar një alternativë më shumë kundrejt *cash*-it.

Është me rëndësi të përmendet se projektligji parashikon mundësinë e përfshirjes në shërbimet e pagesave elektronike edhe të Shoqërive të Kursim Kreditit, të cilat kanë një prezencë të shtuar në zonat rurale, nëpërmjet licencimit si institucion pagese. Në këtë drejtim, kontribute në zgjerimin e prezencës së institucioneve financiare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ka dhe prezantimi dhe rregullimi i modelit të “Bankave që ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve”, zhvillimi i të cilit mund të bazohet pikërisht në bashkëpunimin e bankave me këto institucione financiare jobanka që kanë prezencë edhe në zonat rurale.

Së fundi, kontribut në nxitjen e efikasitetit dhe sigurisë së tregut të remitancave ka edhe regjimi i krijuar për mbrojtjen e konsumatorit pasi ligji rregullon edhe transaksionet ndërkufitare për pjesën e kryer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

⁶ Money Transfer Operator është institucioni financiar jobankë që kryen transfertat parash.

⁷ Praktikë *de-risking* të institucioneve globale financiare kërcënojnë të ndërpresin hyrjen në sistemin financiar global të kompanive të dërgesave dhe të bankave vendase në rajone të caktuara, duke u penguar aksesin në sistemin financiar global (Burimi: Banka Botërore).

KOSTOT DHE KURSIMET E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI. DISA NGJA REZULTATET KRYESORE⁸

Për zhvillimin efikas të tregut të pagesave, që prej vitit 2015, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë analizash dhe studimesh me qëllim identifikimin e boshllëqeve dhe hapësirave për ndërhyrje. Në këtë kuadër, ekspertët e Bankës Botërore të mbështetur nga Banka e Shqipërisë hartuan studimin mbi “Mbi matjen e kostove dhe kursimeve të instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël”. Ky studim synonte identifikimin e kostove të mbartura nga secili aktor i tregut të pagesave me vlerë të vogël. Vlerësimet e marra tregojnë se ekonomia shqiptare ka një kosto ekuivalente me 2.5% të PBB-së së vendit (ose afërsisht në 33.7 miliardë lekë), lidhur me përdorimin, emetimin dhe përpunimin e të gjitha instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël, nga të cilat 1,7% të PBB-së përbën vetëm mbajtja e parasë *cash*. Rezultatet e marra nga skenarët e zëvendësimit tregojnë se zëvendësimi i *cash*-it dhe i instrumenteve me kosto të lartë, me instrumente me efektivitet të lartë dhe kosto të ulët, do të sjellin një vlerë të shtuar jo vetëm për agentët e tregut të instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël, por për të gjithë ekonominë shqiptare.



HYRJE

Për të identifikuar dhe matur kostot dhe kursimet nga instrumentet e pagesave me vlerë të vogël në rastin e Shqipërisë, bazuar në metodologjinë e hartuar nga Banka Botërore⁹, kjo e fundit në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë ndërmorën gjatë viteve 2014 dhe 2016 anketën “Mbi matjen e kostove dhe kursimeve të instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël” drejtuar aktorëve kryesorë të tregut të pagesave: përdoruesit e shërbimit të pagesave, ofruesit e shërbimit të pagesave dhe ofruesit

⁸ Përgatiti Holti Banka, Banka Botërore. Për më shumë konsultoni materialin e plotë, në linkun https://www.bankofalbania.org/rc/doc/WB_RetailPmt_Abania_shqip_12354_1_12371.pdf

⁹ Krijimi kësaj metodologjie nga Banka Botërore synonte krijimin e një përfaqëseje të unifikuar në rrafshin ndërkombëtar, duke mundësuar krahasimin midis vendeve të ndryshme. Gjithashtu, metodologjia ka si synim identifikimin e efekteve nga masat e ndërmarra nga secili vend nëpërmjet përsëritjes periodike të studimit.

e infrastrukturës së pagesave. Përdoruesit e shërbimeve të pagesave (PSU) përbëjnë kahun e kërkesës së aktorëve të tregut të pagesave me vlerë të vogël, të cilët përfshijnë: konsumatorët (kryefamiljari ose pjesëtari i familjes që kryen pagesat), bizneset¹⁰ dhe agjencitë shtetërore¹¹. Të gjithë këta aktorë kanë një rol të dyfishtë në tregun e instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël, pasi mund të jenë njëkohësisht, si pagues ashtu edhe përfitues të disa transaksioneve të pagesave të caktuara. Vlen të theksohet se anketimi i kahut të kërkesës u realizua në vitin 2014.

Ndërsa ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) dhe ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PIP) përbëjnë kahun e ofertës së zinxhirit të vlerave të pagesave. Ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) emetojnë instrumente të pagesave (p.sh. *cash*, kartat e pagesave, paratë elektronike) tek përdoruesit e shërbimit të pagesave (PSU). Nga ana tjetër, ato (PSP) ofrojnë edhe shërbime, të cilat lejojnë përdoruesit e shërbimeve të pagesave (PSU) të iniciojnë pagesa me vlerë të vogël me një instrument të caktuar pagese, duke përfshirë shërbimet mbështetëse/ndihmëse (p.sh. hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive të transaksioneve). Një bankë qendrore zakonisht është emetuese e kartëmonedhave dhe monedhave, ndërkohë që bankat tregtare, institucionet financiare të mikrokredisë, institucionet e parasë elektronike dhe ofrues të tjerë jobanka të shërbimeve të pagesave janë emetues të instrumenteve të pagesave jo-*cash* (duke përfshirë instrumentet e pagesave elektronike). Përveç ofruesve të shërbimeve të pagesave (PSP) që emetojnë instrumente të pagesës, ka edhe institucione të cilat ofrojnë shërbime transaksionesh hyrje dhe dalje *cash*-i (*cash-in/cash-out*), si për shembull operatorët e transferimit të parave ose funksione shtesë (p.sh. zyrat e këmbimit valutor). Ndërsa ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PIP) ofrojnë shërbime të infrastrukturës së pagesave zakonisht tek ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) dhe jo drejtpërdrejt tek përdoruesit e shërbimeve të pagesave (PSU). Shërbimet tipike të ofruara nga ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PIP) përfshijnë shërbime logjistike të *cash*-it ose (për pagesat jo-*cash*) autorizimin, switching/kalimin, klerimin dhe shërbimet e netimit dhe/ose shlyerjes.¹²

Anketimi i kahut të ofertës u krye në vitin 2016. Duke pasur parasysh se kostot e kahut të kërkesës dhe ofertës i përkasin viteve të ndryshme (2014 dhe 2016 respektivisht), me qëllim krijimin e një baze të përbashkët vjetore, shifrat e kahut të kërkesës janë projektuar për vitin 2016 duke përdorur normat e inflacionit. Kështu, të gjitha kostot që i referohen ekonomisë në tërësi shoqërohen me vitin kalendarik 2016.

Metoda e vlerësimit të kostove të transaksioneve të pagesave bazohet në vlerësimin e kostos që ka secila pagesë bazuar në metodën e transmetimit dhe të përdorimit të pagesave. Metoda e transmetimit të pagesës tregon si iniciohet dhe/ose merret një pagesë, që përfshijnë pagesat në person (p.sh. pika e ndërveprimit, ATM, dega e bankës, zyra e pagesës, agjenti) dhe pagesat në largësi (remote) (që bëhen me anë të internetit, rrjetit të telefonit/telefoni celular, si për shembull remitancat, pagesat për mallra/shërbime, pagesat për fatura periodike, pagat, pensionet, ndihmat sociale etj.). Ndërsa metoda e përdorimit vlerëson koston që shoqëron përdorimi i çdo instrumenti pagese. Më poshtë kemi paraqitur vlerësimet për koston e instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël sipas të dy metodave për secilin aktor të tregut të pagesave, si dhe për ekonominë të tërësi.

Një version më të plotë të këtij studimi, si dhe detaje mbi metodologjinë mund ta gjeni në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.¹³

¹⁰ Ndërmarrjet e regjistruara, duke përfshirë shitësit me pakicë, pronar i vetëm (sole proprietorships) dhe ofruesve të vetëpunësuar të mallrave dhe shërbimeve.

¹¹ Që mund të jenë agjenci qeveritare qendrore, rajonale dhe lokale/vendore.

¹² Metodologjia e tanishme ndjek një metodë funksionale dhe jo një qasje institucionale ku identifikon dhe mat shpenzimet që lidhen me ofruesit e shërbimeve të pagesave/ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PSP/PIP). Në varësi të kushteve të tregut, një institucion mund të kategorizohet në ofrues të shërbimit të pagesave (PSP), si dhe në kategorinë e ofruesit të infrastrukturës së pagesave (PIP). Një shembull tipik do të ishin bankat qendrore, të cilat në shumë vende jo vetëm emetojnë vlera monetare/para (një funksion i ofruesit të shërbimit të pagesave - PSP), por gjithashtu ofrojnë shlyerje pagesash dhe nganjëherë edhe shërbime të switching/kalimit, klerimit dhe netimit të pagesave (funksionet e ofruesit të infrastrukturës së pagesave - PIP).

¹³ https://www.bankofalbania.org/rc/doc/WB_RetailPmt_Abania_shqip_12354_1_12371.pdf

INSTRUMENTET E PAGESAVE DHE KOSTOT E TYRE

KAHU I KËRKESËS

- KONSUMATORËT

Bazuar në të dhënat e anketës rezultojnë se konsumatorët në Shqipëri në vitin 2014 kanë kryer në total 127.5 milionë pagesa në vit ose 53 pagesa për frymë¹⁴. Vlerësohet se 96% e pagesave të konsumatorëve janë në *cash* dhe 4% janë pagesa *jo-cash*. Nga pagesat *jo-cash*, 2.2% e tyre janë transfertat direkte të kreditit në formë letër¹⁵, pagesat me kartë debiti dhe krediti, llogariten me 0.6% secila. Ndërsa pagesat me transfertat elektronike të kreditit dhe paratë në internet¹⁶ përbëjnë përkatësisht 0.4% dhe 0.2% të totalit të pagesave. Megjithatë, numri i përgjithshëm i pagesave të iniciuara (veçanërisht përmes *cash-it*) ka gjasa të jetë nënvlerësuar (*underestimated*) për disa arsye.¹⁷

Sipas përdorimit vlerësohet se 64.5% e pagesave totale ose 34.4 pagesa për një të rritur në vit janë bërë për blerjen/shitjen e sendeve ushqimore dhe mallrave të domosdoshme. Pagesat për faturat dhe shërbimet periodike përbëjnë së bashku 30% të të gjitha pagesave, ndërsa pagesat për mallrat e qëndrueshme, pagesat e qeverisë dhe remitanatit bashkërisht përbëjnë 5.5% të të gjitha pagesave të iniciuara vjetore.

Sipas metodave të transmetimit, pagesat e iniciuara në pikën e ndërveprimit përbëjnë 78.5% të pagesave totale; ato në një degë të ofruesit të shërbimit të pagesave (PSP) përbëjnë 11.5% të pagesave totale; ndërsa 10% e pagesave të mbetura janë iniciuar në pikat e agjentëve, ose nëpërmjet internetit. Pagesat në internet përbëjnë vetëm 1.3% të të gjitha pagesave.

Kur shikojmë prerjet e pagesave sipas metodës së transmetimit dhe të përdorimit, vlerësohet se përsëri pagesat *cash* zënë një pjesë të konsiderueshme në totalin e pagesave të iniciuara nga konsumatorët. Kështu, 99% e të gjitha pagesave të iniciuara në pikën e ndërveprimit janë përmes *cash-it*. 81% e pagesave të bëra në degët e bankave janë iniciuar përmes *cash-it*, ndërsa pjesa e mbetur prej 19% janë iniciuar nëpërmjet transfertave të kreditit në formë letër. Mes gjithë pagesave në internet, 35% e tyre janë iniciuar nëpërmjet transfertave elektronike të kreditit, 31% përmes kartës së kreditit, 20% nëpërmjet kartës së debitit dhe 14% janë transaksione nëpërmjet internetit. Për më tepër, 10% e të gjitha pagesave të faturave iniciohen online.

Nga ana tjetër, konsumatorët në Shqipëri marrin përafërsisht 38 milionë pagesa në vit ose 16 pagesa për çdo të rritur në vit, nga të cilat 90% janë pranuar në *cash*, 8% janë pranuar nëpërmjet transfertave direkte të kreditit dhe 2% nëpërmjet parasë në internet.

Sipas qëllimit të përdorimit, 28% e pagesave të konsumatorëve merren për mallra dhe shërbime të ofruara nga individë të tjerë që nuk janë biznese të formalizuara. Pagat dhe pensionet përbëjnë

¹⁴ Për popullsinë në moshë madhore (18+).

¹⁵ Nënkupton iniciimin e pagesës nëpërmjet plotësimit të mandatit në degët ose agjentët e institucionit që kryen këto shërbime.

¹⁶ Duke marrë në konsideratë faktin që në vitin 2014 prezenca e produkteve të parasë elektronike sapo ishte prezantuar, në vërtetë e kryera në kahun e kërkesës u vlerësua të futej koncepti i parasë në internet për të identifikuar përdorimin e shërbimeve si Pay Pal dhe që do të tregonin prirjen e ardhshme të përdorimit të produkteve të parasë elektronike.

¹⁷ Një numër faktorësh kontribuojnë në këtë rezultat. Së pari, në 57% të rasteve, i anketuari nuk është personi përgjegjës për financat e familjes (vetëm në 23% të kampionit personi përgjegjës është edhe kryefamiljari) dhe për këtë arsye ai/ajo mund të mos jetë përgjegjës për pagesat me natyrë periodike për shembull (siç janë faturat e shërbimeve), duke rezultuar kështu me një numër më të vogël pagesash të iniciuara që raportohen. Arsyeja e dytë ka të bëjë me natyrën e pyetësorit, i cili mbështetet në vetëraportimin e të anketuarit lidhur me numrin e pagesave. Me fjalë të tjera, të anketuarit përdorin perceptimet e tyre kur kujtojnë numrin e pagesave që ata bëjnë në një javë, muaj ose vit, dhe si të tillë, ata tentojnë të raportojnë një numër më të vogël pagesash, veçanërisht ato që lidhen me *cash-in*. Arsyeja e tretë lidhet me marrjen e kampioneve. Megjithatë kampioni është përfaqësues në nivel kombëtar, konsumatorët me numër përgjithësisht të ulët pagesash të iniciuara mund të jenë tejkaluar në kampion dhe anasjelltas konsumatorët me nivele më të larta shpenzimesh mund të jenë nënvlerësuar duke çuar në një numër të përgjithshëm të pagesave të nisura në nivel kombëtar të ekstrapoluar. Për shembull, njerëzit me diplomë universitare dhe pasuniversitare, të cilët kanë prirjen të fitojnë më shumë dhe për këtë arsye iniciojnë më shumë pagesa, përbëjnë së bashku vetëm 15% të kampionit. Arsimi është një variabël i rastit, pra nuk kontrollohet.

përkatësisht 23% dhe 20% të pagesave të marra. Kurse remitancat dhe përfitimet e ndihmës sociale përbëjnë 15% dhe 14% të pagesave të marra.

Ndërsa sipas metodës së transmetimit, vlerësohet se një pjesë e rëndësishme e pagesave merret në pikën e ndërveprimit (29%), pasuar nga degët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (PSP) dhe ATM me 21%. Interneti, si kanali i vetëm ekskluziv jo-*cash*, përbën 10% të pagesave të marra, pikat e agjentëve 7% dhe zyrat e pagesave 5%. Nëse rastet e përdorimit të konsumatorëve, do të krahasohen në vend të instrumenteve të pagesave, do të rezultonte që vetëm 5% e të gjitha remitancave individë me individë merren nëpërmjet internetit.

Bazuar në përdorimin aktual të instrumenteve të pagesave të paraqitur më sipër, vlerësohet se përdorimi i instrumenteve të pagesave kanë për konsumatorët shqiptarë një kosto¹⁸ ekonomike vjetore prej 1% të PBB-së¹⁹. Vlerësohet se për konsumatorët përdorimi i *cash*-it ka një kosto ekonomike vjetore sa 0.7% të PBB-së²⁰, ndërsa transfertat e kreditit në formë letër kanë një kosto ekonomike prej 0.12% të PBB-së së vendit.

- BIZNESET

Bizneset shqiptare iniciojnë rreth 18,2 milionë pagesa në vit ose 792 pagesa për një biznes në vit, nga të cilat 66% janë *cash*. Përdorimi i *cash*-it ndryshon sipas madhësisë së biznesit, ku ndërmarrjet mikro iniciojnë 93% të vëllimit vjetor të pagesave në *cash*, ndërsa bizneset e mëdha 47%. Transfertat direkte të kreditit (si në formë letër dhe elektronike) dhe transfertat e debitimit direkt janë instrumentet më të përdorura, përkatësisht në vend të dytë dhe të tretë, pavarësisht madhësisë së biznesit.

Përgjithësisht shumica e pagesave të iniciuara të bizneseve janë për blerjen e mallrave me pakicë dhe të pajisjeve (37% e totalit të vëllimeve vjetore). 20% e totalit të pagesave të iniciuara nga bizneset përfaqësojnë pagat, ndërkohë që faturat periodike dhe sigurime të ndryshme përbëjnë përkatësisht 14% dhe 13% të totalit të pagesave. Vlerësohet se shërbimet dhe pagesa të tjera, siç janë tatimet dhe detyrimet, përbëjnë secila 10% dhe 6% të totalit të pagesave. Bazuar në metodën e transmetimit, 54% e pagesave të iniciuara nga biznesi bëhet nga pikat e ndërveprimit, ndërsa pagesat e degëve të internetit dhe pagesat në degët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (PSP) përbëjnë secila nga 23% të pagesave të iniciuara nga bizneset. Pagesat në *cash*, pavarësisht mënyrës së transmetimit, zënë një peshë të konsiderueshme në totalin e pagesave. Ato përbëjnë 97% të totalit të pagesave në pikën e ndërveprimit dhe 57% të pagesave brenda bankës. Përsa i përket pagesave të iniciuara përmes internetit, transfertat elektronike të kreditit përbëjnë gjysmën e këtyre pagesave, pasuar nga debitimet direkte (27%), dhe të ndjekura nga pagesat me kartë krediti dhe debiti (përkatësisht 13 dhe 9%).

Në anën tjetër, bizneset në Shqipëri kanë pranuar (marrë) 274 milionë pagesa çdo vit ose 2,543 pagesa për një biznes në vit. Shumica dërrmuese e të gjitha pagesave janë marrë nga ndërmarrjet mikro²¹ dhe janë marrë kryesisht në *cash*. Vërehet gjithashtu se të gjitha llojet e bizneseve kanë marrë pagesa me karta debiti dhe krediti, por bizneset e mëdha zënë një pjesë më të madhe. Siç pritej, transfertat elektronike të kreditit dhe transfertat e debitimit direkt nuk janë të rëndësishme për ndërmarrjet mikro dhe bizneset e vogla, por përdoren më së shumti nga bizneset e mesme dhe të mëdha. Të dhënat gjithashtu tregojnë se pjesa më e madhe e të gjitha pagesave elektronike të pranuar nga bizneset përfaqësohet nga transfertat elektronike të kreditit, jo nga pagesat me karta, të cilat vijnë në vendin e dytë.

¹⁸ Kostoja totale për instrument përcaktohet si nga vëllimi i transaksioneve, ashtu edhe nga vetë kostoja e lartë për transaksion. Kostoja e *cash*-it ndikohet si nga vëllimi i lartë i transaksioneve në *cash*, ashtu edhe nga kostoja që ka ky instrument.

¹⁹ PBB-ja e vitit 2014.

²⁰ PBB-ja e vitit 2014 për Shqipërinë u vlerësua në 1.8 trilionë lekë ose \$14.5 miliardë.

²¹ Mund të duket një paradoks që shumica dërrmuese e të gjitha pagesave janë marrë nga mikro ndërmarrjet, por ka disa arsye që e përligjin. Së pari, për shkak të natyrës së tyre, mikro ndërmarrjet pranojnë shumë pagesa me vlerë të vogël në baza ditore, meqë ato shpesh janë dyqane me pakicë "të lagjes" që ofrojnë mallra dhe shërbime, përkundrazi disa prej bizneseve të mëdha, që mund të jenë fabrika dhe nuk bëjnë transaksione aq të shpeshta. Së dyti, mikro-ndërmarrjet përbëjnë një pjesë të madhe të totalit të bizneseve në Shqipëri dhe duke u kombinuar me numrin e shpeshtë të transaksioneve, rritet numri i përgjithshëm i pagesave që mikro-ndërmarrjet pranojnë në të gjithë vendin.

Në total, bizneset në Shqipëri kanë shpenzime vjetore të barabarta me 0.6% të PBB-së në kontekstin e marrjes dhe inicimit të pagesave nëpërmjet gjithë instrumenteve të pagesave, ku vetëm *cash*-i përfaqëson 0.30% të PBB-së ose gjysmën e kostove totale. Në krahasim, kostoja e transfertave të kreditit në formë letër llogaritet në 0.13% të PBB-së, transfertat elektronike të kreditit në 0.05%, debitimet direkte në 0.04%, kartat e debitit dhe të kreditit, nga 0.03% secila.

- AGJENCITË SHITËTORE

Të dhënat e gjeruara nga anketimet rezultuan të kufizuara, kryesisht të gjeneruara nga të dhënat e Drejtorisë së Thesarit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat nuk mundësojnë dezagregimin e pagesave sipas metodologjisë së aplikuar. Në nivel pushteti vendor, të dhënat përfshijnë vetëm ato të Bashkisë së Tiranës. Vlerësohet se agjencitë qeveritare në Shqipëri u japin konsumatorëve rreth 17.5 milionë pagesa në vit. Rreth 50% e të gjitha pagesave të iniciuara nga agjencitë qeveritare është në *cash*, transfertat e kreditit në formë letër përbëjnë rreth 20% të të gjitha pagesave të iniciuara dhe transfertat elektronike të kreditit rreth 30%. Vlerësohet se agjencitë qeveritare marrin një total prej 1.8 milionë pagesash, kryesisht nga konsumatorët me një vëllim vjetor prej rreth 1.3 milionë pagesash, si dhe rreth gjysmë milioni pagesash nga bizneset.

Matjet për vitin 2014 tregojnë që kostoja vjetore e *cash*-it për agjencitë qeveritare është 0.02% e PBB-së, kostoja e transfertave elektronike të kreditit është 0.004% të PBB-së dhe kostoja e përdorimit të transfertave të kreditit në formë letër është 0.003% të PBB-së. Arsyeja pse transfertat elektronike të kreditit janë paksa më të kushtueshme, në total, sesa transfertat e kreditit në formë letër, qëndron te vëllimi më i madh i transfertave elektronike të kreditit që përdoren në nivel qeveritar në Shqipëri.

KAHU I OFERTËS

- OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE DHE OFRUESIT E INFRASTRUKTURËS SË PAGESAVE

Nga të dhënat e anketës së zhvilluar gjatë vitit 2016 për bankat dhe institucionet e parasë elektronike në Shqipëri, u vlerësua se këto institucione procesuan 12 milionë pagesa/transferta²², afërsisht 2 dhe 1 milion më shumë pagesa krahasuar me shifrat e vitit 2014 dhe 2015 respektivisht. Nga këto, gjatë vitit 2016, 44.7% ishin pagesa elektronike, përkundrajt 33.4% dhe 37.5% për vitet 2014 dhe 2015, respektivisht.

Në vitin 2016, kahu i ofertës të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri procesoi rreth 22.5 milionë tërheqje *cash*²³ dhe 10.5 milionë depozita.²⁴ Tërheqjet e *cash*-it janë rritur me kalimin e kohës, por shkalla e rritjes së tyre është ulur ndjeshëm, nga 27% në periudhën 2014-2015, në 7% në periudhën 2015-2016. Në mënyrë të ngjashme, depozitat në *cash* shfaqën një rritje të ndjeshme midis viteve 2014 dhe 2015, duke arritur një normë rritjeje prej 94%; megjithatë, norma e rritjes u kthye në negative midis viteve 2015 dhe 2016, pasi depozitat në *cash* pësuan rënie me 14%.

Në përgjithësi, vlerësohet se kahu i ofertës ka kosto vjetore të barabartë me pothuajse 9 miliardë lekë (\$154 milionë) ose 1.31% të PBB-së së Shqipërisë për vitin 2016, e lidhur me të gjitha instrumentet e analizuara të pagesave²⁵. *Cash*-i shfaqet si instrumenti më i kushtueshëm i pagesave në baza agregate, i barabartë me 0.65% të PBB-së (8.9 miliardë lekë ose \$77 milionë) dhe përgjegjës për gati gjysmën

²² Pagesat/transfertat siç janë përcaktuar këtu përfshijnë vetëm transaksionet e bëra për blerjen e mallrave/shërbimeve, detyrimet e qeverisë dhe transferimet midis palëve të kryera, duke përdorur instrumente elektronike të pagesave, p.sh. duke përjashtuar *cash*-in dhe çeqet.

²³ Këtu janë përfshirë tërheqjet me karta debiti, krediti dhe kartat e parapaguara, meqë transaksione të tilla trajtohen ndarazi nga pagesat me karta, dhe janë të lidhura me transaksionet e *cash*-it dhe kostot e *cash*-it. Tërheqjet gjithashtu përfshijnë tërheqjen e parasë elektronike tek agjentët e institucioneve të parasë elektronike.

²⁴ Depozitat përfshijnë depozitimin e *cash*-it tek agjentët e institucioneve të parasë elektronike.

²⁵ Megjithatë kartat e parapaguara janë analizuar nën aspektin e flukseve të vëllimeve të pagesave dhe të emetimit ndër kohë, ato nuk analizohen nën aspektin e kostos për arsye se nuk janë ofruar të dhëna të tilla.

e kostove totale. *Cash*-i ka pothuajse trefishin e koston së instrumentit të dytë më të kushtueshëm të pagesës, që është karta e debitit, në 0.25% të PBB-së (3.3 miliardë lekë ose \$29 milionë) ²⁶. Karta e kreditit renditet e treta me 0.21% të PBB-së (3 miliardë lekë ose \$26 milionë) ²⁷, e ndjekur nga transfertat e kreditit me 0.1% të PBB-së (1.3 miliardë lekë ose \$11.5 milionë), debitimi direkt me 0.06% të PBB-së (0.8 trilionë lekë ose \$7 milionë), dhe paraja elektronike me 0,04% të PBB-së (0.5 miliardë lekë ose \$4.5 milionë).

- KOSTOT TOTALE PËR EKONOMINË NË TËRËSI

Në material, përveç kostove për agjentët veç e veç, janë trajtuar edhe kostot për të gjithë ekonominë e Shqipërisë. Vlen të theksohet se, për të shmangur mbivlerësimin në nivelin ekonomik, kostot e transferimit midis palëve të interesuara janë hequr nga llogaritjet, pasi ato përbëjnë të ardhura për disa palë. Si të tilla, merren parasysh vetëm kostot e burimeve për secilën palë të interesuar për vlerësimin e kostove totale të ekonomisë për instrumentet e ndryshme të pagesave.

Për më tepër, duke pasur parasysh se kostot e kahut të kërkesës dhe ofertës i përkasin viteve të ndryshme (2014 dhe 2016 respektivisht), me qëllim krijimin e një baze të përbashkët vjetore, shifrat e kahut të kërkesës janë axhustuar për vitin 2016, duke përdorur normën e inflacionit. Kështu, të gjitha kostot që i referohen ekonomisë në tërësi i përkasin vitit kalendarik 2016.

Vlerësimet tregojnë se ekonomia shqiptare ka një kosto ekuivalente prej 2.5% të PBB-së së vendit, lidhur me përdorimin, emetimin dhe përpunimin e të gjitha instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël. Kjo përkthehet afërsisht në 33.7 miliardë lekë ose \$290 milionë. Vërehet se ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) dhe ofruesit e shërbimeve të infrastrukturës (PIP) mbajnë rreth 40% të këtyre kostove, të ndjekur nga konsumatorët me 36%, bizneset me 23% dhe qeveria që mban 1% të koston totale.

Tabelë 1. Kostot totale të ekonomisë për të gjitha instrumentet e pagesave me vlerë të vogël të shqyrtuara (2016)

Llojet e kostove Aktorët		Burimet e kostove	Kostot e transferuara	Kostot totale për aktor
Kahu i kërkesës	Konsumatorët	12.2 miliardë LEKË \$105 milionë	6.4 miliardë LEKË \$55 milionë	18.6 miliardë LEKË \$160 milionë
	Bizneset	7.8 miliardë LEKË \$67 milionë	2.8 miliardë LEKË \$24 milionë	10.6 miliardë LEKË \$91 milionë
	Agjencitë qeveritare	328.3 milionë LEKË \$2.8 milionë	87.8 milionë LEKË \$0.8 milionë	416.1 milionë LEKË \$3.6 milionë
Kahu i ofertës	Ofruesit e Shërbimit të Pagesës (PSP) / Of-ruesit e infrastrukturës së Pagesës (PIP)	13.4 miliardë LEKË \$115.2 milionë	4.6 miliardë LEKË \$39.6 milionë	18 miliardë LEKË \$154.8 milionë
Kostot totale në ekonomi		33.7 miliardë LEKË \$290 milionë 2.5% e PPB		


Burimi: Kostot dhe Kursimet e Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri, Banka Botërore, Banka e Shqipërisë (2016).

Përsa i përket instrumenteve të pagesave, në nivel ekonomie, *cash*-i është në shumicën dërrmuese instrumenti më i kushtueshëm, i cili i kushton Shqipërisë rreth 1.7% të PBB-së në vit. Më tutje vijnë kartat e debitit, kartat e kreditit dhe transfertat e kreditimit në formë letre, ku secila prej tyre i kushton ekonomisë rreth 0.2% të PBB-së. Pjesa e mbetur prej 0.2% e PBB-së është kostoja kumulative e burimeve të lidhura me debitimet direkte (në formë letër dhe elektronike), paraja elektronike dhe paraja në internet.

²⁶ Fakti që në total kartat e debitit janë më të kushtueshme se kartat e kreditit vjen kryesisht për shkak të vëllimit më të madh të transaksioneve me kartë debiti të procesuara nga kahu i ofertës, në krahasim me kartat e kreditit.

²⁷ Arsyeja pse kartat e debitit tregojnë kosto më të lartë sesa kartat e kreditit në total është: edhe pse transaksionet me kartë krediti shoqërohen me tarifa më të larta për transaksion se kartat e debitit, vëllimi më i lartë i transaksioneve me kartë debiti zbeh ndryshimin e tarifës së transaksionit, duke rritur koston e kartave të debitit më të lartë se ato të kartave të kreditit.

Grafik 2. Kostoja totale e ekonomisë (burimi) sipas instrumentit të pagesës si % e PBB-së së vitit 2016



Burimi: Kostot dhe Kursimet e Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri, Banka Botërore, Banka e Shqipërisë (2016).

Në përgjithësi, kur zëvendësohet *cash*-i dhe pagesa të tjera në formë letër me pagesa elektronike në nivel ekonomie, Shqipëria mund të gjenerojë kursime vjetore afërsisht sa 0.6% të PBB-së të vitit 2016 (në skenarin që të gjitha instrumentet e pagesave aktuale në formë letër janë zëvendësuar me instrumente të pagesave elektronike). Janë përdorur tre shkallë të konvertimit hipotetik prej 35%, 70% dhe 100% në mënyrë që të projektohen kursime të hollësishme/detajuara nga në formë letër në ato elektronike.

Në rastin e *cash*-it, skenarët më të mundshëm të zëvendësimit në periudhën afatshkurtër dhe të mesme janë ato me 35% dhe 70% të konvertimit. Kështu kursimet për ekonominë shqiptare mund të ndryshojnë nga 160 milionë lekë në 3.5 miliardë lekë në skenarin e konvertimit 35% (tabela 3, kolona e dytë) ose nga 362 milionë lekë në 7.3 miliardë në skenarin e konvertimit me 70% (tabela 3, kolona e tretë).

Ndërsa në rastin e transfertave të kredisë në formë letre, skenari më i mundshëm është ai i zëvendësimit 100% dhe si i tillë, kursimet mund të ndryshojnë nga 1.1 miliardë lekë në 8.2 miliardë lekë (tabela 3, kolona e katërt).

Ngjashëm, në rastin e debitimeve direkte në formë letër, skenari më i mundshëm është ai i një zëvendësimi dhe si i tillë, kursimet mund të ndryshojnë nga 1.2 miliardë lekë në 1.3 miliardë lekë (tabela 3, kolona e katërt).

Tabelë 2. Skenarët e zëvendësimit dhe kursimet në nivel ekonomie

Skenarë Zëvendësimi / Fusha e kursimeve	Kursimet: Shkalla e konvertimit 35%			Kursimet: Shkalla e konvertimit 70%			Kursimet: Shkalla e konvertimit 100%		
	LEKË	\$	% e PBB 2016	LEKË	\$	% e PBB 2016	LEKË	\$	% e PBB 2016
Cash → Transferta Elektronike të Kreditit	3.5 miliardë	30.1 milionë	0.252	7.3 miliardë	62.8 milionë	0.526	11.8 miliardë	101.5 milionë	0.850
Cash → Kartë Debiti	1.9 miliardë	16.3 milionë	0.136	3.9 miliardë	33.5 milionë	0.280	7.9 miliardë	68 milionë	0.570
Cash → Debitimi Direkt Elektronik	1.8 miliardë	15.5 milionë	0.130	4.2 miliardë	36.1 milionë	0.302	7.7 miliardë	66.2 milionë	0.554
Cash → Kartë Krediti	1.7 miliardë	14.6 milionë	0.122	3.5 miliardë	30.1 milionë	0.252	7.6 miliardë	65.4 milionë	0.548
Cash → Paraja në internet	1 miliardë	8.6 milionë	0.072	2.1 miliardë	18 milionë	0.150	3 miliardë	25.8 milionë	0.216
Cash → Paraja Elektronike	160 milionë	1.4 milionë	0.012	362 milionë	3.1 milionë	0.026	681.6 milionë	5.9 milionë	0.049
Transferrat e kreditit në formë letër → Transferta Elektronike të Kreditit	2.2 miliardë	18.9 milionë	0.160	4.3 miliardë	37 milionë	0.310	8.2 miliardë	70.5 milionë	0.600
Transferrat e kreditit në formë letër → Paraja në Internet	760 milionë	6.5 milionë	0.055	1.5 miliardë	12.9 milionë	0.108	2.7 miliardë	23.2 milionë	0.195
Transferrat e kreditit në formë letër → Paraja Elektronike	312 milionë	2.7 milionë	0.022	760 milionë	6.5 milionë	0.055	1.1 miliardë	9.5 milionë	0.080

Debitimi Direkt në formë letër → Debitimi Direkt Elektronik	460 milionë	4 milionë	0.033	700 milionë	6 milionë	0.050	1.3 miliardë	11.2 milionë	0.094
Debitimi Direkt në formë Letër → Paraja Elektronike	296 milionë	2.5 milionë	0.020	637 milionë	5.5 milionë	0.046	1.2 miliardë	10.3 milionë	0.086

Burimi: Kostot dhe Kursimet e Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri, Banka Botërore, Banka e Shqipërisë (2016)

Analiza lejon edhe derivimin e skenarëve të mëposhtëm të zëvendësimit hipotetik sipas rasteve të përdorimit. Në mënyrë të veçantë, një normë konvertimi 50% përdoret për të sjellë kursimet e mundshme për secilin aktor në ekonomi, në varësi të rastit të përdorimit dhe instrumentit të pagesës që e zëvendëson. Rastet e përdorimit të mëposhtëm u morën në analizë, duke pasur parasysh se ato përbëjnë llojet më të shpeshta të pagesave:

- pagesa për mallra/shërbime në pikën e shitjes;
- pagesa për faturat e shërbimeve; pensionet;
- remitancat; pagesa të inventarit midis bizneseve.

Vlerësimet tregojnë që kursimet janë të konsiderueshme si për konsumatorët, bizneset dhe agjencitë qeveritare. Tabela 4 paraqet në mënyrë të detajuar kursimet që mund të përfitonte secili agjent në rastin e përdorimit të formave të ndryshme të pagesave.

Tabelë 3. Skenarët e zëvendësimit dhe kursimet për rastet treguese të përdorimit të aktorëve të ndryshëm

Rastet e përdorimit: Pagesat për blerjen e ushqimeve dhe mallrave të domosdoshme (P2B) Skenari i zëvendësimit: <i>Cash</i> → Kartë Debiti Konvertimi: 50%		
Kursimet për konsumatorët	Kursimet për bizneset	Kursimet për PSP/PIP
120 milionë Lekë \$1 milionë	600 milionë Lekë \$5.2 milionë	400 milionë Lekë \$3.5 milionë
Rastet e përdorimit: Pagesat për faturat utilitare (P2B) Skenari i zëvendësimit: <i>Cash</i> → Debitimi Direkt Elektronik Konvertimi: 50%		
Kursimet për konsumatorët	Kursimet për bizneset	Kursimet për PSP/PIP
750 milionë Lekë \$6.5 milionë	ALL 1 trilionë Lekë \$8.2 milionë	ALL 1.8 billion \$15.5 milionë
Rastet e përdorimit: Pensionet (G2P) Skenari i zëvendësimit: <i>Cash</i> → Transferta Elektronike të kreditit Konvertimi: 50%		
Kursimet për konsumatorët	Kursimet për agjenci qeveritare	Kursimet për PSP/PIP
385 milionë Lekë \$3.3 milionë	350 milionë Lekë \$3 milionë	500 milionë Lekë \$4.3 milionë
Rastet e përdorimit: Remitancat (P2P) Skenari i zëvendësimit: <i>Cash</i> →Transferta Elektronike të kreditit Konvertimi: 50%		
Kursimet për konsumatorët	Kursimet për PSP/PIP	
300 milionë Lekë \$2.6 milionë	800 milionë Lekë \$6.7 milionë	
Rastet e përdorimit: Remitancat (P2P) Skenari i zëvendësimit: <i>Cash</i> →Para elektronike Konvertimi: 50%		
Kursimet për konsumatorët	Kursimet për PSP/PIP	
150 milionë Lekë \$1.3 milionë	450 milionë Lekë \$3.9 milionë	
Rastet e përdorimit: Pagesat e inventarit (B2B) Skenari i zëvendësimit: Transferta Krediti në formë letër→ Transferta Elektronike të kreditit Konvertimi: 50%		
Kursimet për bizneset	Kursimet për PSP/PIP	
750 milionë Lekë \$6.5 milionë	1.6 trilionë Lekë \$13.8 milionë	

Burimi: Kostot dhe Kursimet e Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri, Banka Botërore, Banka e Shqipërisë (2016)

PËRFUNDIME

Simulimet e bazuara në analizën e kahut të kërkesës dhe të ofertës sugjerojnë që në Shqipëri mund të arrihen përmirësime të konsiderueshme në efikasitet, nëse *cash*-i dhe pagesat e tjera në formë letër, ose një pjesë e tyre, do të zëvendësoheshin me instrumente elektronike të pagesave me kosto të ulët. Kështu, kostoja aktuale e pagesave në formë letër në nivel ekonomie arrin në rreth 1.7% të PBB-së së vendit. Ndërsa nga një konvertim prej 70% të pagesave nga letër në elektronike, kursimet mund të arrijnë në 0.9% të PBB-së. Nga zëvendësimi i instrumenteve të pagesave do të përfitonin një numër aktorësh, por përfitimet më të mëdha do të ishin për konsumatorët dhe bizneset, të cilët mbajnë edhe pjesën më të madhe të kostove, të ndjekur nga ofruesit e shërbimeve të pagesave/ infrastrukturës (PSP/PIP). Gjithashtu, një përdorim më efikas i pagesave elektronike mund të sjellë përfitime të konsiderueshme për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit.

Lind pyetja se çfarë mund të bëhet për të përshpejtuar përparimin e Shqipërisë në zvogëlimin e përdorimit të *cash*-it dhe paralelisht në rritjen e pagesave elektronike. Është e rëndësishme të theksohet se disa zhvillime të hershme po na çojnë në drejtimin e duhur. Përdorimi i përgjithshëm i transfertave elektronike të kreditit, debitimit direkt dhe i kartave të pagesave kanë dëshmuar përmirësime thelbësore; megjithatë, vëllimi i këtyre transaksioneve është ende i ulët në krahasim me vëllimin e përgjithshëm të *cash*-it dhe transaksionet e tjera në formë letër. Gjithashtu, produktet e parasë elektronike po tregojnë potencial zhvillimi. Vlen të theksohet se, ndryshimet strukturore si zhvillimet e nevojshme infrastrukturore, ato ligjore e rregullative, si dhe familjarizimi i aktorëve për zhvendosjen nga përdorimi i instrumenteve në formë letre në më shumë instrumente elektronike të pagesave mund të pritët të jenë të ngadalta. Megjithatë, ndryshimet në metodat e transmetimit të instrumenteve të pagesave në formë letër duket se janë urgjente pasi ato rezultojnë në kostot më thelbësore nga perspektiva e përdoruesit të tyre. Kështu, edhe zbatimi i planifikuar i debitimit direkt ndërbankar do të kontribuonte në shërbime më efikase të pagesave të faturave. Aktualisht, debitimet direkte brenda të njëjtës bankë, të iniciuara nëpërmjet internetit u rritën me 55% në vitet 2015-2016. Lejimi i debitimeve direkte ndërbankare pritët të përshpejtojë më tej nivelin e rritjes së debitimeve elektronike direkte në të ardhmen.



Për të stimuluar përdorimin e llogarive të transaksioneve, bankat dhe PSP-të duhet të zhvillojnë një rrjet më të gjerë të pikave të aksesit, si në pronësi fizike të tyre, ashtu edhe në pronësi të palëve të treta (veçanërisht terminale POS dhe agjentët) dhe në distancë (p.sh. telefona celulare, internet banking). Nga ana tjetër, konsumatorët shqiptarë duhet t'i njohin më mirë avantazhet që ofrojnë pagesat me kartë, duke bërë që ato të pranohen gjerësisht prej tyre si mjet pagese. Gjithashtu, në tregje ku ka pak zotërues kartash, tregtarët kanë më pak të ngjarë të pranojnë pagesa elektronike, pasi kërkesa e ulët e klientit ul më tej interesin nga ana e tregtarëve. Për më tepër, modelet tradicionale të blerjeve (POS) mund ta kenë të vështirë të arrijnë tek shitësit me pakicë në zona periferike dhe rurale.


Në ekonominë shqiptare, zëvendësimi i pagesave *cash* nga ato elektronike në pikat e bashkëveprimit është shumë i rëndësishëm. Vëllimet e krijuara në instrumentet e pagesave elektronike si rezultat i zëvendësimit (pagesat e nisura nga konsumatori në *cash* në pikën e bashkëveprimit arrijnë në 99 milionë) dhe mund t'i kursenin bizneseve deri në 600 milionë lekë (\$5.2 milionë) çdo vit. Gjithashtu, i rëndësishëm është zëvendësimi i pagesave *cash* nga ato elektronike në degën e bankës. Ky zëvendësim duhet kombinuar me reduktimin e koston nga zëvendësimi i rrjetit të degëve, që vlerësohet i kushtueshëm, me rrjet agjentësh (nëpërmjet prezantimit të bankave që operojnë nëpërmjet një rrjeti agjentësh), i cili vlerësohet se ka kontribut në reduktimin e kostove të krijuara nga koha e shpenzuar, veçanërisht në zonat rurale. Prezantimi i modelit të bankës që operon me agjentë mund të shërbejë edhe si zbutës në pengesat kulturore dhe të besimit në institucionet bankare.

Zgjerimi i online dhe internet banking, si dhe shfrytëzimi i produkteve të parasë elektronike si mjet për pagesat e faturave është kritik për të ndërprerë metodat e tjera të kushtueshme të transmetimit të pagesave *cash* dhe instrumenteve të pagesave në formë letër (p.sh. zyra e pagesës). Për më tepër, nxitja e përdorimit të terminaleve POS përmes stimuljeve fiskale dhe monetare nga qeveria dhe industria, do të jetë e rëndësishme.

Analiza gjithashtu thekson se tarifat e procesimit të kartave të pagesave përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të koston, i mbartur nga bankat. Vlerësohet se si për kartat e debitit dhe të kreditit, kjo tarifë procesimi është sa 31% e koston totale të kartës. Në rrethana të caktuara, procesimi i kartave brenda vendit mund të kontribuojë në zvogëlimin e disa prej këtyre kostove, të cilat janë strategjikisht operacionale për bankat, duke pasur parasysh rritjen e transaksioneve me kartat e debitit, si mjeti më dinamik i instrumentit të pagesave elektronike në Shqipëri.

Në përgjithësi, edhe pse *cash*-i ende mbizotëron dhe është mjaft i kushtueshëm për Shqipërinë, një zëvendësim i tij me pagesa elektronike do të sjellë përfitime dhe ulje kostosh të rëndësishme për të gjithë aktorët e tregut. Industria bankare, autoritetet qeveritare dhe Banka e Shqipërisë duhet të përdorin të dhënat e nxjerra nga kjo analizë për të bërë ndryshimet e nevojshme në terren dhe për të përshpejtuar më tej këtë proces.

Statistika mbi remitancat



Statistika mbi Shqipërinë	
Popullsia 1 janar 2019 (milionë)	2.86
Rritja e popullsisë (% mesatare 2011-2019)	-0.22
Densiteti i popullsisë 2019 (banorë për km ²)	100.4
Forca e punës (milionë) 2018	1.4
Norma e papunësisë (%) 2018	12.8
Popullsia urbane (%) 2011	55.0
Sipërfaqja (km)	28748
Produkti i Brendshëm Bruto, PBB (miliardë euro), 2018	12.8
BBP për frymë	4465.79
Rritja e BBP-së (% mesatare 2010-2018)	3.9
Raporti i varfërisë në numrin e varfërisë kombëtare 2012 (%)	14.3
Shkalla e punësimit (% e popullsisë në moshë pune) 2018	59.5
Numri i llogarive bankare (% mbi moshën 15 vjeç), 2017	40.0
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare (për 100 banorë) 2018	94.8

Burimi: INSTAT, AKEP Raporti Vjetor 2018, llogaritjet e BSh

Emigracioni	
Stoku i emigrantëve, 2019 (milionë)	1.21
Stoku emigrantëve/ndaj popullsisë (%)	42.17
Vendet me emigracion më të lartë	Itali, Greqi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Maqedoni, Mbretëria e Bashkuar, Gjermani, Kanada, Francë, Belgjikë

Burimi: Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2019.

Remitancat milionë euro	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Flukset hyrëse të remitançave	1,269.91	1,232.24	1,198.43	1,114.44	1,104.20	964.81	1,073.25	1,165.11	1,179.84	1,157.95	1,236.96
nga të cilat											
Të ardhura nga puna	183.95	163.17	174.87	138.66	118.42	189.23	250.05	271.20	279.75	285.49	309.47
Transferta personale	1,085.96	1,069.08	1,023.56	975.78	985.78	775.58	823.20	893.91	900.09	872.47	927.49
Flukset dalëse të remitançave	191.18	164.48	158.05	108.40	168.04	143.45	134.77	138.27	132.72	94.51	97.51
nga të cilat											
Të ardhura nga puna	10.66	6.19	11.61	10.23	28.97	35.09	30.44	25.89	19.40	22.52	24.54
Transferta personale	180.52	158.29	146.43	98.18	139.07	108.36	104.32	112.38	113.32	71.99	72.97

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2017.

NDIKIMI I MBAJTJES SË PARASË “CASH”²⁸

HYRJE

Në këtë seksion përfshihet një vlerësim mbi impaktin makroekonomik nga mbajtja e parasë *cash* nga individët dhe biznesi në Shqipëri. Impakti nënkupton “humbjen” në terma të aktivitetit ekonomik në formën e një “kostoje oportune”. Analiza bazohet në vlerësimin e koston së mbajtjes së parasë *cash* nga individët dhe bizneset sipas “Studimit mbi kostot e pagesave të vogla në Shqipëri”, i cili vlerëson koston e mbajtjes së parasë *cash* nga individët dhe bizneset si përqindje ndaj PBB-së nominale të vitit 2014. Përqasja analitike nis me supozimin se individët dhe bizneset nuk do të mbanin para *cash* dhe për rrjedhojë nuk do të rëndoheshin me kostot respektive. Kjo e ardhur shtesë do të mund të përdorej për rritje të kërkesës agregate. Në këtë rast supozohet se individët do të zgjeronin konsumin privat, ndërkohë që bizneset do të zgjeronin investimet. Impakti i këtyre zhvillimeve në zgjerimin e produktit të brendshëm bruto real bazohet mbi përqasjen input-output. Hapi final analizon ndikimin në terma të rritjes ekonomike (në pikë përqindje) për periudhën 2014-2018.

PËR INDIVIDËT

Sipas “Studimit mbi kostot e pagesave të vogla në Shqipëri”, kostoja e parasë *cash* për individët vlerësohet në 0.7% ndaj PBB-së nominale të vitit 2014. Në këtë analizë, supozohet që kostoja në proporcion me PBB-në do të ishte e njëjtë edhe për vitet në vazhdim. Më tej supozohet që në kushtet e mosmbajtjes së parasë *cash*, këto kosto do të ishin të lira për t’u përdorur për qëllime të tjera. Në këtë rast, supozohet se konsumi i popullatës do të rritet në nivel të njëjtë me koston e çliruar për horizontin e analizës 2014-2018.

Sipas përqasjes input-output, zgjerimi i konsumit të popullatës përkthehet në zgjerim të Produktit të Brendshëm Bruto për ekonominë në terma nominalë në dy nivele. Niveli i parë lidhet me rritjen e PBB-së paralelisht me rritjen e konsumit (ndikimi direkt). Në hapin e dytë, supozohet një impakt i dytë zinxhir si rrjedhojë e rritjes së të ardhurave në ekonomi (ndikim indirekt). Në bazë të deflatorëve vjetorë të PBB-së sipas llogarive kombëtare, vlerësohet impakti në terma të PBB-së reale. Kjo mundëson edhe vlerësimin në terma të rritjes ekonomike në pikë përqindje. Në tabelën e mëposhtme, paraqitet pikërisht ndikimi në rritjen ekonomike, si pasojë e ndikimit direkt, indirekt dhe total të rritjes së konsumit të popullatës.

Tabelë 1. Ndikimi në rritjen ekonomike si pasojë e rritjes së konsumit të popullatës (pikë përqindje) për periudhën 2014-2018

	Impakti (pp)
Direkt	0.4
Indirekt	0.1
Total	0.5

Burimi: INSTAT dhe vlerësim të autorëve.

Për periudhën 2014-2018, rritja ekonomike e Shqipërisë llogaritet në 3.1% si mesatare e periudhës, duke variuar nga 1.8% (viti 2014), në 4.1% (viti 2018). Si rrjedhojë e impaktit direkt të rritjes së konsumit, rritja ekonomike do të kishte qenë rreth 3.5%. Nëse shtohet edhe ndikimi indirekt i rritjes së konsumit, rritja ekonomike do të kishte shënuar 3.6%.

PËR BIZNESET

Përqasja për vlerësimin e ndikimit makroekonomik të mosmbajtjes së parasë *cash* në rastin e bizneseve, ndjek të njëjtën logjikë sikurse në rastin e individëve. I vetmi dallim është që në rastin e bizneseve,

²⁸ Punoi: Enian Çela.

supozohet një rritje e investimeve si pasojë e kostove të kursyera nga mosmbajtja e parasë *cash*. Në këtë rast, analiza e kostove vlerëson një impakt në masën 0.3% ndaj PBB-së nominale të vitit 2014. Edhe në këtë rast, analiza përfshin vitet 2014-2018 me ndikimet direkte dhe indirekte, duke supozuar një kosto proporcionale ndaj PBB-së të njëjtë për të gjithë periudhën. Rezultatet janë paraqitur në Tabelën 2.

Tabelë 2. Ndikimi në rritjen ekonomike si pasojë e rritjes së investimeve (pikë përqindje) për periudhën 2014-2018


	Impakti (pp)
Direkt	0.13
Indirekt	0.06
Total	0.2

Burimi: INSTAT dhe vlerësim të autorëve.


Në rastin e bizneseve, impakti në terma të rritjes ekonomike është më i ngadaltë krahasuar me individët, sepse edhe vetë kostoja proporcionale e mbajtjes së parasë *cash* është më e ulët për këtë sektor. Vlerësohet që ndikimi i përgjithshëm me bashkimin e impakteve direkte dhe indirekte mund të arrijë maksimalisht në 0.2 pikë përqindje në rritjen ekonomike të periudhës në analizë. Në këto kushte, rritja ekonomike për vitet 2014-2018, mund të kishte qenë rreth 3.3% krahasuar me rritjen faktike prej 3.1%. Duhet theksuar që analiza nuk përfshin ndikimet e induktuara nga rritja e investimeve në ekonomi. Këto investime shtesë do të ndikonin edhe më tepër në rritjen ekonomike, duke nxitur kërkesën agregate gjatë viteve në vazhdim (efekti *forward linkage*). Me këto ndikime, impakti do të ishte edhe më i lartë.

IMPAKTI I KOMBINUAR

Nëse impaktet individuale nga individët dhe bizneset bashkohen, merret efekti i kombinuar në rritjen ekonomike si pasojë e "eliminimit" të parasë *cash* nga këto subjekte. Vlerësohet që ndikimi vetëm si pasojë e impaktit direkt do të ishte rreth 0.5 pikë përqindje. Me fjalë të tjera, rritja ekonomike mesatare e periudhës 2014-2018 do të arrijë në 3.6%, kundrejt nivelit faktik prej 3.1%. Nëse shtohet edhe impakti indirekt, rritja ekonomike do të arrijë shifrat mesatare 3.8%. Përmbledhja e rezultateve duke vënë në dukje ndikimet e veçanta nga individët dhe bizneset paraqiten në Grafikon 1 (në terma të rritjes ekonomike). Ndërkohë, Grafiku 2 paraqet të njëjtin fenomen, por të parë përmes ndikimeve direkte dhe indirekte.



Grafik 2. Rritja ekonomike faktike dhe sipas ndikimeve direkte dhe indirekte për periudhën 2014-2018 (%)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorëve.



FAMILJET DHE REMITANCAT: EVIDENCË NGA VROJTIMI MBI FINANCAT DHE KONSUMIN E FAMILJEVE SHQIPTARE²⁹

Të dhënat e Vrojtimit mbi financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, zhvilluar nga Banka e Shqipërisë, tregojnë se gjatë vitit 2018, 23% e familjeve shqiptare kanë marrë të ardhura nga emigrantët. Fluksi mesatar vjetor i remitancave për familje vlerësohet afërsisht në 2,018 euro dhe luhet nga qarku në qark. Si numër familjesh, kanë përfituar më shumë remitanca familjet në qarkun e Tiranës, Elbasanit dhe Vlorës. Ndërsa në bazë të shumës së remitancave, përfitues më të mëdhenj janë qarku i Elbasanit, Tiranës dhe Durrësit. Vlerësohet se të ardhurat nga emigrantët janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për familjet shqiptare, duke përbërë 34% të të ardhurave totale mujore të familjes. Të dhënat tregojnë edhe për një përfshirje të ulët financiare të familjeve në Shqipëri, dhe kryesisht të atyre që marrin remitanca. Vetëm 7.5% e familjeve që marrin remitanca kanë një llogari rrjedhëse në bankë dhe 6.2% e familjeve kanë një llogari kursimi.

HYRJE

Emigrimi është cilësuar si një ndër faktorët më të rëndësishëm të shekullit XXI, që ndikon marrëdhëniet ekonomike midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim (Adams dhe Page, 2003). Organizata e Kombeve të Bashkuara, në fillim të këtij shekulli, ka vlerësuar se 2.8% e popullsisë së botës ose rreth 174 milionë njerëz jetojnë dhe punojnë jashtë vendit të lindjes. Edhe shifrat më të fundit tregojnë se emigrimi është një fenomen në rritje, madje vlerësohet se bota në këtë periudhë po përballet me krizën më të thellë të emigrimit që ka parë gjatë gjithë historisë së saj (Banka Botërore, 2019). Vlerësimet e vitit 2019 (Kombet e Bashkuara, 2019), tregojnë që aktualisht numri total i emigrantëve në botë është 274 milionë individë, rritur me 98 milionë (ose 56%) emigrantë krahasuar me shifrat e vitit 2000. Emigrantët në vitin 2019 përbëjnë 3.5% të totalit të popullsisë botërore, ku Evropa dhe Amerika e Veriut vlerësohen të jenë vendet që kanë stokun më të madh të emigrantëve në botë, përkatësisht 82.3 milionë dhe 58.6 milionë.

Emigrimi është një fenomen multidimensional që ndikon si ekonominë e vendeve dërguese, ashtu edhe atë të vendeve pritëse në shumë mënyra. Përveç ndikimit ekonomik, social dhe kulturor që ka emigrimi kryesisht në vendet që eksportojnë emigrantë, të ardhurat që ato dërgojnë në vendin e tyre të lindjes janë ndoshta lidhja më e drejtpërdrejtë midis emigrimit dhe zhvillimit ekonomik të vendit (Ratha, 2007). Në nivel global, të dhënat nga remitancat kanë arritur në nivelin e 689,404 milionë dollarë amerikanë (Banka Botërore, 2019). Këto të ardhura ndikojnë kryesisht në uljen e varfërisë së këtyre vendeve, në mbështetjen e konsumit, rritjen e kursimeve në vend, si dhe në rritjen e ndërmjetësimit financiar, duke përmirësuar kështu perspektivën e rritjes ekonomike (Ratha et al., (2011)). Vlerësimet empirike bazuar në një panel prej 71 vendesh në zhvillim kanë treguar që rritja me 10% e remitancave për frymë ndikon në uljen me 3.5% të popullsisë që jeton në varfëri (Adams dhe Page, 2005). Gjithashtu, literatura empirike ka treguar që të ardhurat nga remitancat kanë shërbyer si stabilizues të ardhurash si për ekonominë në tërësi, ashtu edhe për familjet në mënyrë individuale. Madje është evidentuar që remitancat kanë tendencë të rriten gjatë periudhave të rënies ekonomike, krizave financiare dhe katastrofave natyrore, pasi emigrantët sjellin më shumë para për të ndihmuar familjet e tyre (World Bank 2006b, Yang and Choi 2007, Mohapatra et al. 2010). Studime të tjera tregojnë që të ardhurat nga remitancat sjellin rritje të kursimeve të brendshme dhe si rrjedhojë përmirësojnë ndërmjetësimin financiar. Emigrimi kontribuon në zhvillimin e kapitalit njerëzor, ku një numër i caktuar studimesh sugjerojnë se pjesa kryesore e të ardhurave nga remitancat shpenzohen më së shumti për edukim dhe për shëndetësi se sa për konsum të përditshëm (Adams 2005, Adams et al. 2008, Banka Botërore, 2006b, Valero-Gil 2008 etj.).

²⁹ Përgatiti Elona Dushku, Banka e Shqipërisë. Mendimet e shprehura në këtë material janë vetëm të autorit dhe nuk përfaqësojnë mendimet apo opinionin e Bankës së Shqipërisë.

Përveç ndikimit që kanë remitanecat si në nivel familjeje apo në nivel makroekonomik, me interes ka qenë edhe investigimi i faktorëve që ndikojnë në përcaktimin e remitanecave. Literatura teorike dhe empirike në lidhje me faktorët përcaktues të të ardhurave nga emigrantët ndahet kryesisht në dy drejtime. Drejtimi i parë i literaturës përfshin tërësinë e materialeve studimore që analizojnë faktorët mikroekonomikë në përcaktimin e të ardhurave nga emigrantët. Zanafilla e këtij drejtimi të literaturës bazohet tek materiali i Lucas dhe Stark në 1985, me temë: "Motivation to remit: evidence from Botswana", që është ndër të parët që analizon faktorët përcaktues të remitanecave bazuar në perspektivën mikroekonomike. Lukas dhe Stark evidentuan se motivet kryesore që ndikojnë në dërgimin e remitanecave janë: altruizmi i pastër³⁰, interesat personale³¹ dhe altruizmi i zbutur³².

Pjesa tjetër e literaturës vlerëson se në përcaktimin e remitanecave rëndësi kanë edhe faktorët makroekonomikë, ndër të cilët literatura empirike eidenton: numrin e emigrantëve që ndodhen jashtë, situata ekonomike dhe pagat e vendit ku kanë emigruar, situata ekonomike në vendin e origjinës, kursi i këmbimit dhe normat relative të interesit midis vendit dërgues dhe atij pritës, situata politike, si dhe lehtësirat me të cilat mund të dërgohen këto të ardhura janë disa nga faktorët makroekonomikë që ndikojnë në nivelin e remitanecave. Një përmbledhje të detajuar të literaturës mbi faktorët kryesorë mikroekonomikë dhe makroekonomikë të remitanecave gjendet tek materialet Zanker and Siegel, (2007), Ratha et al, (2011).

Edhe në Shqipëri emigrimi është një fenomen mjaft i përhapur dhe i njohur, me ndikim dhe kosto të rëndësishme për ekonominë tonë. Në vitin 2019 vlerësohet se 1.21 milionë shqiptarë ose 42.7% e popullsisë jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë (Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2019). Në nivel makroekonomik, të ardhurat nga emigrantët ose remitanecat në Shqipëri përbëjnë një ndër flukset më të mëdha valutore që vijnë nga jashtë, si dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të bilancit të pagesave. Mesatarisht, gjatë periudhës 2008-2018, të ardhurat nga emigrantët (remitancat) vlerësohen në 11.7% të PBB-së (Banka e Shqipërisë, 2019). Duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe peshën që ato kanë si për familjet në veçanti, ashtu edhe për ekonominë në tërësi, është me interes të bëhet një analizim më i detajuar i remitanecave për rastin e Shqipërisë.

Të dhënat e agreguara të remitanecave, megjithëse janë burimi kryesor i të ardhurave nga emigrantët, tregojnë pak për dobinë e tyre tek marrësit ose për mënyrën se si marrësit i përdorin këto fonde. Pak dihet rreth karakteristikave, dinamikës, ecurisë dhe ndikimit të këtyre flukseve në nivele personale, familjare dhe komunitetit në Shqipëri. Disa nga materialet që kanë trajtuar fenomenin e remitanecave në Shqipëri janë ato nga Gëdeshi (2000), Frashëri, (2007), Zanger-Siegel, (2007), (Abazaj (2011), Gëdeshi-Jorgoni (2012)). Këto materiale kanë analizuar karakteristikat e emigrantëve shqiptarë, motivet kryesore të dërgimit të remitanecave dhe përdorimit të tyre, duke vlerësuar rëndësinë e remitanecave për familjet shqiptare dhe për ekonominë në periudha kohe të ndryshme.

Pavarësisht studimeve për ndikimin social, demografik dhe ekonomik, ende ka një njohje pjesore të kësaj dukurie tek ne. Kjo pasi mungojnë të dhëna të detajuara në nivel familjeje që japin një vlerësim më të saktë të rëndësisë së këtyre flukseve, duke marrë në konsideratë që ato dërgohen kryesisht në mënyrë informale³³ (Gëdeshi, 2000).

Ky artikull bazohet në të dhënat e marra nga Vrojtimi mbi konsumin dhe financat e familjeve shqiptare, të kryer nga Banka e Shqipërisë në fillim të vitit 2019 dhe prezanton evidencat më të fundit të karakteristikave të familjeve marrëse të remitanecave, vendndodhjen e tyre dhe flukset e marra, si dhe ndikimin që kanë remitanecat në të ardhurat dhe konsumin e familjeve shqiptare.

³⁰ Arsyeja kryesore e dërgimit të remitanecave për arsye altruizmi lidhet me faktin që emigranti kujdeset për familjen e tij dhe synon të ulë varfërinë dhe ta mbrojë nga çdo goditje e mundshme që ndikon në sjelljen e konsumit të tij.

³¹ Dërgimi i remitanecave për interesa personale lidhet me motivin e tyre personal për të bërë një investim në të ardhmen, për të blerë një shtëpi, për hapjen e një biznesi etj., dhe familja përdoret si agjent i besuar për dërgimin e këtyre të ardhurave.

³² Në këtë rast, familja në vendin e origjinës dhe emigranti përfitojnë nga emigrimi në sajë të disa marrëdhënieve kontraktuale që vendosen midis tyre si për shembull për shlyerje kredie, për motive këmbimi, bashkësigurim etj. (Zanger-Siegel, 2007).

³³ Gëdeshi (2000), Frashëri, (2007) vlerësojnë se pjesa më e madhe e emigrantëve, 81-89% e tyre, preferojnë kanalet joformale të dërgimit të remitanecave.

HAPËSIRË INFORMATIVE: VROJTIMI MBI KONSUMIN DHE FINANCAT E FAMILJEVE SHQIPTARE

Qëllimi i vrojtim

Literatura më e fundit empirike ka treguar që vrojtimit mbi financat dhe konsumin e familjeve kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në të kuptuarit e sjelljes së familjes në mënyrë individuale, por edhe të vetë sektorit në tërësi (EHFCN; 2009). Të dhënat në nivel familjeje bëjnë të mundur vlerësimin e goditjeve të ndryshme makroekonomike, politikave dhe reformave të ndërmarra ndërmjet grupeve të ndryshme të familjeve.

Analizimi në nivel mikro i familjeve është shumë i rëndësishëm dhe me vlerë të shtuar për bankat qendrore në funksion të objektivit dhe politikave të saj. Familjet janë shumë heterogjene ndërmjet njera-tjetrës, jo vetëm për sa i përket nivelit të ndryshëm të financave, por edhe për sa i përket sjelljes ndaj politikave të ndryshme makroekonomike.

Kjo ka bërë që vëmendje akoma edhe më e madhe t'i kushtohet analizimit të të dhënave në nivel mikro për të ilustruar më mirë heterogjenitetin që ekziston në të dhënat e familjes, gjë e cila është e vështirë për t'u identifikuar dhe për t'u eksploruar bazuar në të dhënat e agreguara.

Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë ndërmori gjatë periudhës mars-prill 2019, Vrojtimin mbi Financat dhe Konsumin e Familjeve Shqiptare, mbështetur në metodologjinë e vrojtimit të bërë nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Metodologjia

Vrojtimi mbi Financat dhe Konsumin e Familjeve Shqiptare u zhvillua në terren nga INSTAT dhe kishte për qëllim mbledhjen e informacionit nga 2,500 familje shqiptare në lidhje me pasurinë reale dhe financiare të tyre, detyrimet dhe investimet financiare, si dhe shpenzimet dhe të ardhurat e familjes.

Zgjedhja e familjeve në të gjithë territorin është bërë në mënyrë rastësore nga INSTAT, bazuar në parimin e proporcionalitetit për të pasur një përfaqësim të plotë të gjithë familjeve shqiptare në gjithë territorin e Shqipërisë. Anketa e vrojtimit bazohet në anketën e hartuar nga HFCN (Household Finance and Consumption Network), që udhëhiqet nga Banka Qendrore Evropiane në bashkëpunim me bankat e tjera qendrore të 20 vendeve anëtare, si dhe është përshtatur nga Banka e Shqipërisë, në linjë me karakteristikat e familjeve shqiptare dhe të ekonomisë sonë. Ajo është e organizuar në 8 rubrika kryesore me informacion mbi përbërjen familjare, pasuritë e patundshme të familjes; kreditë e lidhura me banesën kryesore; aktivet financiare që ka familja; punësimin, të ardhurat e secilit individ mbi 16 vjeç, të ardhurat e familjes, shpenzimet e konsumit dhe të kursimit të familjeve.

Informacioni i vrojtimit u mbledh me intervista direkte. Ekipi i intervistuesve u përzgjedh nga INSTAT dhe përbëhej nga individë, të aktivizuar më parë në vrojtime të ngjashme të kryera nga Banka e Shqipërisë dhe vetë INSTAT. Hedhja e të dhënave është bërë nga INSTAT, ndërsa përpunimi dhe analizimi i tyre nga Banka e Shqipërisë. Duhet të nënvizojmë që analiza bazohet në të dhëna të peshuara, sipas peshave të marra nga INSTAT për çdo familje të vrotuar. Peshimi i informacionit të mbledhur bën të mundur marrjen e vlerësimeve të sakta dhe domethënëse për të gjitha familjet dhe popullsinë në Shqipëri.


ANALIZA E REZULTATEVE TË VROJTIMIT

Nga tërësia e të dhënave të marra për familjet shqiptare nga Vrojtimi mbi financat dhe konsumin e familjeve shqiptare për vitin 2019, në këtë material do të paraqesim një analizë mbi profilin e familjeve që kanë përfituar remitanca, fluksin mesatar të tyre, si dhe disa nga karakteristikat e këtyre familjeve.

Profili i familjeve që përfitojnë remitanca


Bazuar në të dhënat e vrojtimit, 22.6% e familjeve shqiptare ose 174,613 nga 773,128 familje në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përfitojnë dërgesa nga jashtë në formën e remitancave. Fluksi mesatar vjetor i të ardhurave nga emigrantët është në nivelin 2,018 euro, kurse mediana³⁴ është në nivelin 1,200 euro (Grafiku 1). Përqindëshja e 25-të e të ardhurave nga emigrantët vlerësohet 500 euro në vit, ndërsa përqindëshja e 75-të është 2,400 euro në vit. Vlerësohet se 59% e familjeve marrin nga 94 deri në 1,200 euro të ardhura nga emigrantët në vit, 37% marrin nga 1,201 deri në 6,000 euro remitanca në vit dhe 3,8% e familjeve marrin mbi 6,000 euro remitanca në vit (Grafiku 2).

Grafik 1. Të ardhurat vjetore nga emigrantët (euro)



Burimi: "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, Banka e Shqipërisë", Viti 2019.

Grafik 2. Histograma e flukseve vjetore të remitancave për vitin 2018 (në euro)



Burimi: "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, Banka e Shqipërisë", Viti 2019.

Tabela 1 paraqet një përmbledhje të shpërndarjes gjeografike të familjeve që kanë marrë të ardhura nga emigrantët, si dhe flukset e tyre vjetore gjatë vitit 2018. Të dhënat tregojnë që familjet që kanë marrë më shumë të ardhura nga emigrantët kanë qenë ato të qarkut të Tiranës, Elbasanit dhe Vlorës (Tabela 1, kolona 7). Ndërsa sipas shumës, përfitues më të mëdhenj kanë qenë qarku i Elbasanit, Tiranës dhe Durrësit (Tabela 1, kolona 8).

Tabelë 1. Shpërndarja gjeografike e familjeve përfituese dhe fluksi i remitancave për vitin 2018

(I)	(II)	(III)	(IV)	(V)	(VI)	(VII)	(VIII)
Qarku	Popullsia	Sipërfaqja (km ²)	Rrethi	Nr. familjeve që kanë marrë remitanca	Shuma (euro) vjetore	% e familjeve, ndaj totalit të familjeve që kanë marrë remitanca	% ndaj totalit të shumës vjetore të remitancave të gjithë popullatës
Berat	127,431	1,802	Berat, Kuçovë, Skrapar	5,070	8,017,801	2.90%	2.29%
Dibër	120,978	2,507	Bulqizë, Dibër, Mat	6,895	15,068,094	3.95%	4.30%


³⁴ Mediana është një tregues më i mirë përkundrejt mesatares, pasi tregues të tillë si të ardhurat, aktivet, borxhi, pasuria neto marrin vlera shumë të mëdha (outliers) dhe vlerat e medianës janë më pak të ndjeshme ndaj tyre.

Durrës	289,628	827	Durrës, Krujë	14,790	48,665,059	8.47%	13.89%
Elbasan	278,547	3,278	Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin	31,667	75,616,145	18.14%	21.58%
Fier	298,144	1,887	Fier, Lushnjë, Mallakastër	15,268	20,521,919	8.74%	5.86%
Gjiro-kastër	62,952	2,883	Gjirokastër, Përmet, Tepelenë	4,513	3,933,388	2.58%	1.12%
Korçë	210,178	3,711	Korçë, Kolonjë, Devoll, Pogradec	14,806	26,755,338	8.48%	7.64%
Kukës	77,394	2,373	Has, Kukës, Tropojë	3,552	5,197,840	2.03%	1.48%
Lezhë	126,800	1,581	Kurbin, Lezhë, Mirditë	6,375	9,898,925	3.65%	2.83%
Shkodër	204,994	3,562	Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë	15,745	40,460,659	9.02%	11.55%
Tiranë	883,996	1,586	Tiranë, Kavajë	38,746	72,764,817	22.19%	20.77%
Vlorë	189,282	2,706	Delvinë, Vlorë	17,187	23,464,869	9.84%	6.70%
Total	2,870,324	28,703		174,614	350,364,853	2.90%	100.00%

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, viti 2019".

Nga analiza mbi madhësitë e familjeve marrëse të remitancave, rezulton se 79% e familjeve kanë mesatarisht deri në 4 anëtarë për familje, nga ku pjesa më e madhe e familjeve që marrin remitanca kanë 2-3 anëtarë për familje.

Grafik 3. Shpërndarja e familjeve që marrin të ardhura nga emigrantët sipas madhësisë së familjes




Burimi: "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, Banka e Shqipërisë", Viti 2019.

Familjet janë pyetur në lidhje me të ardhurat totale mujore neto, që përbëhen nga dy komponentë kryesorë. Komponenti i parë përbëhet nga të ardhurat që vijnë kryesisht nga puna, vetëpunësimi, pensioni etj. Ndërsa komponenti i dytë përfshin të ardhurat e tjera të familjes, që janë të ardhurat nga ndihma sociale, të ardhurat nga emigrantët, të ardhurat nga qiraja, të ardhurat nga interesi, të ardhura nga biznesi apo të ardhura të tjera. Në Grafikon 4 kemi paraqitur shpërndarjen e të ardhurave totale mujore neto të familjeve në Shqipëri. Nga të dhënat e vërtetimit rezulton se mediana e të ardhurave mujore neto të familjes është 50,000 lekë, ndërsa mesatarja është 86,123 lekë (Grafiku 4). Vlerësohet se gjysma e familjeve (50.3%) në Shqipëri kanë të ardhura midis përqindësimit të 5 (9,000 lekë) dhe të 50 (50,000 lekë). Ndërsa gjysma (49.7%) tjetër e familjeve kanë të ardhura midis përqindësimit të 75 (102,552) dhe përqindësimit të 95 (278,800 lekë), (Grafiku 5).

Nga të dhënat e vërtetimit rezulton se për 86% të familjeve, burimi kryesor i të ardhurave të familjes janë të ardhurat nga puna dhe 14% janë të ardhurat nga burimet e tjera. Për qëllim të artikullit, me


interes janë familjet që marrin të ardhura nga emigrantët. Të dhënat tregojnë se për familjet që marrin të ardhura nga emigrantët, remitancat përbëjnë mesatarisht 34% të totalit të të ardhurave mujore të familjes, ndërsa mediana është 22%.

Grafik 4. Të ardhurat totale mujore të familjes (neto, lekë)



Burimi: "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, Banka e Shqipërisë", Viti 2019.

Grafik 5. Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të ardhurave




Burimi: Banka e Shqipërisë "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Grafiku 6 paraqet shpërndarjen e familjeve që marrin remitanca sipas raportit që zënë remitancat në totalin e të ardhurave. Të dhënat tregojnë që ato janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për këto familje, madje për 24,4% të familjeve ato janë burimi kryesor i vetëm i të ardhurave.

Familjet në këtë vërtetim nuk pyeten për mënyrën e përdorimit të remitancave, por pyeten në përgjithësi për shpenzimet totale mujore të familjes që përfshijnë: shpenzimet për ushqim dhe pije-joalkoolike brenda shtëpisë, shpenzim për ushqim jashtë shtëpisë, shpenzim për energji elektrike dhe shpenzime për ujë, telefon, gaz dhe internet, duke përjashtuar shpenzimet për qira, për pagesa kredie, për polica sigurimi etj.

Të dhënat e tabelës 3 tregojnë se mesatarisht 69% e totalit të shpenzimeve mujore të familjeve në Shqipëri shkon për ushqime, ndjekur nga shpenzimet për energji elektrike (12%), shpenzimet për

Grafik 6. Shpërndarja e familjeve sipas raportit në përqindje që zënë të ardhurat nga emigrantët në totalin e të ardhurave mujore të familjes



Burimi: Banka e Shqipërisë "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

ushqim jashtë shtëpisë (10%) dhe shpenzim për ujë, gaz, internet (9.9%). Gjithashtu, në Tabelën 2 janë paraqitur shpenzimet sipas zërave duke bërë diferencimet midis familjeve që marrin remitanca dhe atyre që nuk marrin. Të dhënat nuk tregojnë për ndonjë ndryshim të rëndësishëm të sjelljes së shpenzimeve të familjeve midis këtyre dy grupimeve të familjeve.

Tabelë 2. Shpenzimet sipas zërave për totalin e familjeve


		Mesatarja	Mediana	Përqindësi 25	Përqindësi 75
Shpenzimet për ushqim ndaj totalit të shpenzimeve	Totali i familjeve	68.61%	69.44%	60.61%	77.32%
	Familjet që marrin remitanca	68.69%	68.97%	61.22%	76.92%
	Familjet që nuk marrin remitanca	68.59%	69.69%	60.61%	77.37%
Shpenzim për ushqim jashtë shtëpisë ndaj totalit të shpenzimeve	Totali i familjeve	10%	7.41%	0.00%	14.81%
	Familjet që marrin remitanca	8.76%	7.35%	0.00%	12.77%
	Familjet që nuk marrin remitanca	9.96%	7.41%	0.00%	15.38%
Shpenzim për energji elektrike ndaj totalit të shpenzimeve	Totali i familjeve	11.74%	10.53%	7.77%	14.29%
	Familjet që marrin remitanca	12.05%	11.11%	7.87%	14.71%
	Familjet që nuk marrin remitanca	11.65%	10.34%	7.75%	14.21%
Shpenzim për ujë, gaz, internet ndaj totalit të shpenzimeve	Totali i familjeve	9.89%	8.97%	6.25%	12.31%
	Familjet që marrin remitanca	10.42%	9.26%	6.25%	12.86%
	Familjet që nuk marrin remitanca	9.74%	8.71%	3.08%	12.12%

Burimi: Banka e Shqipërisë "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Familjet në vërtetim janë pyetur në lidhje me sjelljen e tyre të kursimit. Të dhënat tregojnë se mesatarisht 38% e familjeve shqiptare kursejnë. Të ndara në dy grupime, familjet që marrin remitanca përkundrazi atyre që nuk marrin, vërehet se familjet që marrin remitanca kursejnë më shumë se familjet që nuk marrin remitanca (Grafiku 7).


Familjet janë pyetur gjithashtu edhe për motivin kryesor të kursimit, duke i renditur motivet³⁵ nga ai më i rëndësishëm tek ai më pak i rëndësishëm. Të dhënat e vërtetimit (Grafiku 8) tregojnë se dy arsyt kryesore të kursimit të familjeve kanë qenë: kursime për vitet e daljes në pension dhe për edukimin e fëmijëve, pavarësisht nëse familjet marrin ose jo remitanca.

Grafik 7. A kursejnë familjet shqiptare?



Burimi: Banka e Shqipërisë "Vërtetimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Grafik 8. Arsyet e kursimit të familjeve shqiptare




Burimi: Banka e Shqipërisë "Vërtetimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Studimet e bëra për dërgesat e remitancave në Shqipëri, tregojnë që pjesa më e madhe e tyre vjen në mënyrë informale (Gësheshi (2002), Frashëri (2007)). Megjithatë, për të pasur një kanalizim më të mirë të këtyre fondeve në ekonomi dhe rritjen e aksesit në financim kërkohet të kemi një rritje të përfshirjes financiare të popullsisë. Në vërtetim, familjet janë pyetur në lidhje me pasjen apo jo të një llogarie bankare, depozite kursimi, karte krediti apo llogarie overdrafti. Në Grafikon 9, kemi paraqitur të dhënat mbi përfshirjen bankare të familjeve që marrin remitanca dhe atyre që nuk marrin. Të dhënat tregojnë që përgjithësisht niveli i përfshirjes financiare është i ulët, por është akoma edhe më i ulët për familjet që marrin remitanca, vlerësuar si nga përqindja e familjeve që kanë llogari rrjedhëse, depozita me afat apo llogari overdrafti.

³⁵ Për blerjen e një shtëpie; për blerje të tjera të mëdha (si shtëpi të tjera, automjete, mobilje, pajisje të tjera); për të ngritur një biznes privat ose për të financuar biznesin ekzistues investime në pasuri financiare; për shlyerjen e borxheve; për kursime pleqërie; udhëtime/pushime; edukimin/përkrahjen e fëmijëve ose nipërve; përkujdesje për prindërit e moshuar; për dhurata/detyrime shoqërore; të tjera.

Grafik 9. Përfshirja financiare e familjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë "Vrojtimi mbi Financat dhe konsumin e familjeve shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Literatura teorike dhe empirike thekson rëndësinë që kanë të ardhurat nga emigrantët si për ekonominë në tërësi, ashtu edhe për familjet në veçanti. Bazuar në rëndësinë që kanë remitancat në Shqipëri, jo vetëm në aspektin makroekonomik por kryesisht në atë mikroekonomik, është me interes dhe me vlerë të shtuar analizi i tyre. Në këtë material sollëm disa prej karakteristikave kryesore të remitancave në Shqipëri, nga këndvështrimi i familjeve pritëse, bazuar në të dhënat e Vrojtimit për konsumin dhe financat e familjeve shqiptare, zhvilluar nga Banka e Shqipërisë në fillim të vitit 2019. Në vërtetim nuk merret informacion për karakteristikat e emigrantëve, prandaj analiza e karakteristikave të emigrantëve dhe të arsyeve të dërgimit të remitancave nuk është pjesë e kësaj analize.

Nga të dhënat e Vrojtimit arritëm në përfundimin se gjatë vitit 2018, rreth 23% e familjeve shqiptare kanë qenë përfituese të remitancave. Mediana vjetore e të ardhurave nga emigrantët në nivel familjeje vlerësohet 1,200 euro, ndërsa mesatarja vlerësohet 2,018 euro. Pjesa më e madhe e familjeve përfituese të remitancave janë të vendosura në qarkun e Tiranës, Elbasanit dhe të Vlorës. Ndërsa sipas shumës së remitancave, përfitues më të mëdhenj janë qarku i Elbasanit, Tiranës dhe Vlorës.

Ndikimi i remitancave në familjet shqiptare është i rëndësishëm pasi ato përbëjnë mesatarisht 34% të totalit të të ardhurave mujore të familjes. Madje, për 24,4% e familjeve që marrin remitanca, ato janë burimi kryesor dhe i vetëm i të ardhurave të familjes.

Në lidhje me shpenzimet totale mujore dhe mënyrën e bërjes së tyre, vërehet se nuk ka ndryshime në sjellje për sa i përket familjeve që marrin remitanca dhe atyre që nuk marrin. Të dhënat tregojnë se për të dy grupet e familjeve, 69% e totalit të shpenzimeve mujore shkon kryesisht për ushqim dhe pije alkoolike në shtëpi. Gjithashtu, familjet janë pyetur nëse kursejnë apo jo dhe cilat janë arsyet kryesore të kursimit. Mesatarisht vlerësohet se 38% e totalit të familjeve shqiptare kursejnë. Për më tepër vërejmë se familjet që marrin remitanca kursejnë pak më shumë se ato që nuk marrin remitanca. Në lidhje me arsyet kryesore të kursimit, të dhënat tregojnë se të dy grupet e familjeve (si ato që marrin remitanca dhe ato që nuk marrin remitanca) kursejnë kryesisht për të pasur të ardhura gjatë moshës së pleqërisë, si dhe për edukimin e fëmijëve. Gjithashtu, të dhënat tregojnë për një përfshirje të ulët financiare të familjeve shqiptare dhe kryesisht të atyre që marrin remitanca. Vetëm 7.5% e familjeve që marrin remitanca kanë një llogari rrjedhëse në bankë dhe 6.2% e familjeve kanë një llogari kursimi. Në përfundim, vlerësojmë se remitancat përveç ndikimit makroekonomik, përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash për familjet shqiptare, duke ndikuar në sjelljen e tyre të konsumit dhe të kursimit. Gjithashtu, nëse do të kishim një përfshirje më të gjerë financiare të familjeve që marrin remitanca, këto fonde të marra mund të ndikojnë më shumë në thellimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar në vend.

REFERENCA

- Abazaj, E. (2011).** "Ecuria e remitancave në Shqipëri për periudhën 1996-2010 dhe faktorët përcaktues të tyre". Banka e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, 6M-2011.
- Adams, R.H., & J. Page, (2003).** "International Migration, Remittances and Poverty in Developing Countries." World Bank Policy Research Working Paper, No. 3179, The World Bank.
- Adams, R.H., & J. Page, (2005).** "Do International Migration and Remittances Reduce Poverty in Developing Countries?" World Development, Vol. 33, No. 10, pp. 1645-1669.
- Banka Botërore (2006b).** "Global Economic Prospects 2006: Economic Implications of Remittances and Migration". Washington DC: World Bank.
- Banka Botërore (2019).** "Migration and Brain Drain"; Europe and Central Asia Economic Update, Fall, 2019.
- Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës (2019).** "Raport Vjetor mbi Instrumentat e Pagesave: Kosova në krahasim me vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore". Prishtinë: Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës.
- Banka e Shqipërisë, (2018a).** "Remitancat: një mbështetje për zhvillim". Tiranë: Banka e Shqipërisë.
- Banka e Shqipërisë, (2018b).** "The retail payments costs and savings in Albania". Tiranë: Banka e Shqipërisë.
- Chami, R. (2008).** "Remittances and Institutions: Are Remittances a Curse?". IMF Working Paper WP/08/29, IMF.
- Chami, R., D. Hakura, & P. Montiel, (2009).** "Remittances: An Automatic Output Stabilizer?" IMF Working Paper WP/09/91, IMF.
- Eurosystem Household Finance and Consumption Network (2009).** "Survey data on household finance and consumption: research summary and policy use". Occasional Paper 100, European Central Bank.
- Frashëri, A. (2007).** "Informacion mbi rezultatet e vërtetimit pranë familjeve", Banka e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, Vëllimi 10, nr. 3.
- Gëdeshi, I. (2000).** "Role of Remittances from Albanian Emigrants and Their Influence in the Country's Economy". Eastern European Economics, vol. 40, no. 5.
- Gësheshi, I., & E. Jorgoni, (2012).** "Social impact of emigration and rural-urban migration in Central and Eastern Europe". Final country report, European Commission.
- Lucas, R., & O. Stark, (1985).** "Motivations to remit: evidence from Botswana". Journal of Political Economy, 93(5): 901-917.
- Mohapatra, S., G. Joseph, & D. Ratha. (2009).** "Remittances and Natural Disasters, Ex-post Response and Contribution to Ex-ante Preparedness". World Bank Policy Research Working Paper, No. 4972.
- Ratha, D., S. Mohapatra, & E. Scheja, (2011).** "Impact of Migration on Economic and Social Development". World Bank Policy Research Working Paper, WP5558.
- Valero-Gil, J. (2008).** "Remittances and the Household's Expenditure on Health." MPRA Paper, No. 9572, University Library of Munich, Germany.
- World Bank (2006).** "Global Economic Prospects: Economic Implications of Remittances and Migration". Washington, DC.
- World Bank (2007).** "General principles for international remittance services". Washington, DC.
- World Bank (2017).** "The Global Findex Database 2017". Washington, DC.
- Yang, D. (2006).** "Coping with Disaster: The Impact of Hurricanes on International Financial Flows, 1970-2001."
- NBER Working Paper Series, No. 12794,** National Bureau of Economic Research.
- Yang, D. (2008).** "International Migration, Human Capital, and Entrepreneurship: Evidence from Philippine Migrant's Exchange Rate Shocks." The Economic Journal, Royal Economic Society, Vol. 118(528), pp. 591-630.
- Yang, D., & H. Choi, (2007).** "Are Remittances Insurance? Evidence from Rainfall Shocks in the Philippines". The World Bank Economic Review, Vol. 21, No. 2, pp. 219-248.
- Zanker, J. H., & M. Siegel, (2007).** "The determinants of remittances: A review of the literature". Working Paper MGSOG 003, USA: Maastricht University.